

Procesverbal

Nga Mbledhja I (e parë) e jashtëzakonshme (e dhjeta me radhë) për vitin 2024 e Kuvendit Komunal në Dragash, e mbajtur më datë: 14.10.2024

Rend Dite

1. Propozim-vendim për miratimin e Raportit të Komisionit për Vlerësimin e Dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera; dhe
2. Rishqyrtimi i Vendimit për miratimin e Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF).

Arijeta Skeraj: Përsëndetje kryetar i Komunës, z.Bexhet Xheladini! Përsëndetje për të gjithë anëtarët e Kuvendit! Përsëndetje për OSBE-në, media dhe të gjithë ju të pranishëm! Mirë se erdhët në Seancën e parë të jashtëzakonshme (e dhjeta me radhë) për vitin 2024! Këtë seancë të jashtëzakonshme unë dhe kryetari e kemi thirrë menjëherë pas pranimit të Raportit nga Komisioni për Vlerësimin e Dëmeve, në mënyrë që të mos vonohet nga ne si Kuvend që ta dërgojmë në Qeveri për kompenzim. Andaj, ju ftoj që ta mbështesni këtë raport, pasi që është në të mirë të qytetarëve. Ndërsa, pika e dytë është rishqyrtimi i Vendimit për miratimin e Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare. Këtë pikë e kemi future në rend të ditës, pasi që janë afatet ligjore që të rishqyrtohet. Andaj, në mënyrë që të mos kemi ndëshkime ligjore, e kemi future në këtë seancë të jashtëzakonshme. Materialin besoj që e keni pranuar të gjithë. Pasi që është seancë e jashtëzakonshme, nuk mund të shtojmë apo të heqim pika nga rendi i ditës. Pikat e rendit të ditës janë: Propozim-vendimi për miratimin e Raportit të Komisionit për Vlerësimin e Dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera; dhe pika e dytë është: Rishqyrtimi i Vendimit për miratimin e Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare. Atëherë, menjëherë fillojmë me diskutimin e pikës së parë të rendit të ditës.

Bexhet Xheladini: E nderuar kryesuese e Kuvendit, të nderuar delegatë, i nderuar Komision Komunal për Vlerësimin e Dëmeve, të nderuara media, përfaqësues të OSBE-së dhe ju të pranishëm të tjerë! Ju falënderoj për pjesëmarrjen në këtë seancë të jashtëzakonshme, ku do të shqyrtohen dy pika shumë të rëndësishme të rendit të ditës. Siç e dini, para më shumë se dy muajve kemi pasur vërshime. Pas vërshimeve, menjëherë ditën e nesërme, unë si kryetar i Komunës kam thirrë kryetarin e Komisionit Qendror për Vlerësimin e Dëmeve, i cili ka pranuar ftesën dhe të njëjtën ditë ka marrë pjesë në takimin që e kemi mbajtur në zyrën e Nënkryetarit, ku kanë marrë pjesë të gjitha strukturat e Komunës, duke përfshirë edhe kryesuesen e Kuvendit. Në atë takim, kryetari i Komisionit Qendror na ka dhënë

instruksione se si duhet të veprojmë me procedurë për vlerësimin e dëmeve, si në infrastrukturë publike, po ashtu edhe dëmet në ekonomi familjare, biznese dhe bujqësi. Dëmet që janë shkaktuar në infrastrukturë publike, brenda 7 ditëve, Komisioni Komunal dhe grupi i inxhinierëve i ka vlerësuar dëmet, e ka përgatit raportin, projektin, paramasën dhe paralogarinë. Këtë raport ne ditën e shtatë të dëmeve ia kemi dërgue Qeverisë, Kryeministrit Kurti edhe MAPL-së. Nga kryetari i Komisionit na është thënë se Raporti i dëmeve në infrastrukturë publike nuk duhet të çohet në Asamble dhe ajo nuk duhet ta votojë. Për atë edhe ne këtë e kemi çue drejtpërdrejt në Qeveri. Kam prit unë dy javë që Qeveria ta qet në shqyrtim dëmet që janë shkaktuar në infrastrukturë publike. Duke marrë parasysh se Qeveria këtë nuk e ka bo, atëherë unë tri herë radhas, para mbledhjes së Qeverisë, me email e kam njoftuar dhe kryeministrin, edhe ministrin e MAPL-së, që në mbledhjen e radhës të Qeverisë ta qesin për shqyrtim. Sot e kësaj dite ne nuk kemi asnjë informatë lidhur me këtë çështje. Për këtë unë desha të sqaroj – sepse ka pas disa reagime, pse nuk është prurë në Asamble ky Raport. Raporti nuk është prurë në Asamble, për arsye se nuk ka pas nevojë. Mirëpo, sot ne jua kemi prurë një informatë juve, ta dini që sa janë dëmet që janë shkaktuar në infrastrukturë publike. Para se me e bo Raportin përfundimtar të dëmeve që janë shkaktuar në bujqësi, ekonomi familjare dhe biznese, prapë kryetari i Komisionit me ftesën time ka ardhë, me dy anëtarë të tjerë, dhe e ka mbajtur një takim me anëtarët e Komisionit Komunal për Vlerësimin e Dëmeve, ku anëtarët e Komisionit, bashkë me kryetarin, i kanë dhënë instruksione Komisionit Komunal se si duhet të plotësohen formularët. Kështu që, Komisioni Komunal e ka bo vlerësimin dhe, pas pranimit të Raportit, unë me kryesuesen e kemi caktuar mbledhjen e jashtëzakonshme të cilën po e mbajmë sot. Mirëpo, në ndërkohë, disa persona të cilëve u janë shkaktuar dëme, kanë prurë dokumentacione shtesë dhe ne jemi detyruar që ta editojmë atë listë - Komisioni në të vërtetë – dhe jua ka prurë listën tjetër të plotësuar dhe edituar me të dhëna tjera. Dje LVV-ja ka bo një reagim lidhur me Raportin e Komisionit. Unë mendoj që ky ishte një reagim pak i ngutur dhe nuk është dashtë të bëjë këtë. Për atë, ky Raport nuk është përfundimtar, që e ka dhënë Komisioni Komunal. Për atë, ligji e parasheh që ky Raport të vijë në Asamble, ajo ta diskutojë, ta përmirësojë ose ta miratojë ashtu qysh është dhe pastaj, pas votimit në Asamble, njerëzit kanë të drejtë të bëjnë reagime të ndryshme lidhur me Raportin, nëse ka gabime. Ju të nderuar delegatë, e keni të drejtën që secili prej jush këtu, nëse keni dyshime, anëtarët e Komisionit të cilët e kanë bërë vlerësimin e dëmeve janë këtu, e kanë të gjithë dokumentacionin komplet, dhe për secilin person që ju dyshoni mund të kërkoni dokumentacionin. Anëtarë i Komisionit ka me dalë këtu, me i tregue para kamerave dokumentacionin, fotografitë. Pastaj, ju do ta keni në dorë dosjen e personave të cilëve u është bërë vlerësimi i dëmeve. Kështu që, unë këtij Kuvendi i dëshiroj sukses, unë ma shumë nuk po e zgjas. Mund të kyçem në diskutim nëse ka nevojë. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit, kryetar! Të nderuar asambleistë, a doni ju me e marrë fjalën, apo të ia kalojmë një herë kryetarit të Komisionit, pastaj me ju dhënë hapësirë juve me e marrë fjalën, për mos me dalë dy-tri herë? Atëherë, i lusim prej Komisionit që të na sqarojnë për këtë punë që e kanë bërë.

Florim Krasniqi: Përshëndetje, kryesuese! Përshëndetje delegatë! Unë jam Florim Krasniqi, zyrtar për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor pranë Kuvendit Komunal, njëherit jam kryetar i Komisionit për Vlerësimin e Dëmeve, të cilin e ka formue kryetari i Komunës më datë 26.06.2024. Anëtarë të tjerë të Komisionit janë: Vetim Hasani – anëtar; Xhytbehari Taipi – anëtar; Kerim Latifi – anëtar; Abdurrezak Mehmeti – anëtar; dhe Adem Emini – sekretar i Komisionit. Me emërimin e anëtarëve të Komisionit, Komisioni ka bërë analizën për organizimin dhe përpilimin e hartimit të dokumentacioneve përkatëse, si një kornizë ligjore e cila i ka paraprirë kësaj pune. Komisioni ka pas angazhim maksimal, vështirësi, ka punue jashtë orarit, ditëve të vikendit, ka punue me ngarkesa në terren. Kemi pas raste kur kemi shkue nga dy-tri herë, ka pas mungesa të dokumentacioneve të ndryshme. Por, besoj se anëtarët e Komisionit kanë dhënë maksimumin e tyre. Ky Raport që është prezantuar, dëmet kanë qenë për Komunë tonë mjaft të larta. Kemi dëme në infrastrukturë, kemi dëme në ekonomi familjare, në bujqësi dhe biznese. Numri i përgjithshëm i kërkesave është 233 kërkesa, duke i përfshirë të gjitha llojet e dëmeve. Ndërsa, në infrastrukturë kemi disa dëme të cilat është dashtë të intervenohet urgjentisht, në sistemin e ujësjellësve, kanalizimit, ujërave atmosferikë, në rrjetet energjetike dhe në prona të cilat kanë qenë të rrezikuara nga këto vërshime. Sa i përket infrastrukturës, Komisioni ka hartuar dhe përpiluar të gjithë dokumentacionin përkatës, dhe me siguri ju është ofruar materiali. Dëmtime më të mëdha ka pas në fshatin Kuk, në Kosavë, Blaç, Zaplluxhe, Brodosanë, Radeshë e kështu me radhë. Është hartuar i gjithë dokumentacioni teknik dhe është dërguar në instancat më të larta. Shuma e përgjithshme e dëmtimit në infrastrukturë kap shifrën prej 541,438.84 Euro. Kjo vlerë kap projektet të cilët janë hartuar dhe dërguar në institucionet qendrore të RKS-së. Duhet të cekim se, brenda një afati shumë të shkurtër, Komisioni ka dhënë vlerësimet e veta në infrastrukturën që është dashtë të intervenohet me urgjencë. Për shembull, në rrjetet e kanalizimit, për shkak të infeksioneve, dhe sistemet e ujësjellësve, është dashtë me urgjencë. Sa i përket dëmeve të cilat janë shkaktuar në ekonomi familjare, edhe këtu kemi pas dëmtime serioze, sidomos në fshatin Kuk e Bresanë, kanë qenë dëmtime më të theksuara. Vlera e përgjithshme e dëmtimeve të ekonomive familjare kap shumën prej 528,988.10 Euro, apo shprehur me përqindje, 77.9%. Në bujqësi, gjithashtu, këto fshatra që i cekim më parë dhe në fshatrat siç është fshati Pllajnik, kemi dëmtime diku 99,120.13 Euro apo 19.7%. Sa u përket dëmeve të shkaktuara në biznese, kemi vlerën prej 34,900.00 Euro apo 2.4%. Totali i përgjithshëm i dëmeve kap shifrën prej 663,008.23 Euro – është numri i përgjithshëm i dëmtimeve në ekonomi familjare, bujqësi dhe biznes. Kërkesat të cilat janë paraqitur, ne kemi prit disa herë, kemi dhënë afate kohore disa herë, kemi thirrë nëpërmjet telefonit dhe mënyra tjera të komunikimit, që t'i ofrojnë dokumentacionet. Një numër i tyre jetojnë në

disaporë dhe kjo kategori ka pas vështirësi me e sjellë dokumentacionin. Disa nuk kanë qenë fare. Ka pas pengesa dhe vështirësi bukur të mëdha në këtë drejtim, por jemi munduar që të bëjmë më të mirën të mundshme. Nuk pretendojmë diçka të jashtëzakonshme, por jemi munduar me e dhënë maksimumin. Problem tjetër ka qenë se disa i kanë dhënë me vonesë dhe jashtë afatit kohor dokumentacionet. Mendoj që edhe këto duhet të futen, nuk janë shumë raste, diku 5-10 raste të tilla. Duhet të futen në këtë Raport, disa veç e kanë pru sot dokumentacionin përkatës, sepse pa dokumentacion ne nuk kemi mundur të bëjmë vlerësim. Pa fotografi, letërnjoftim e disa dokumente përkatëse, nuk kemi mund me e dhënë një vlerësim më adekuat. Ne ju kemi dhënë si material edhe dëmet fshat për fshat në infrastrukturë, dhe llojet e projekteve i keni pas. Por gjithashtu, edhe në ekonomitë familjare, në bujqësi dhe biznes, i kemi ndarë edhe fshat për fshat dëmet të cilat i kanë pësue. Është bërë vlerësimi në bazë të udhëzimeve dhe rekomandimeve të tyre, ne e kemi bërë vlerësimin përmes një table, formule të cilën Agjencioni e përdor edhe në bujqësi Ministria e Bujqësisë. Këto janë në pika të shkurta, sa u përket këtyre. Ne jemi të hapur për çdo sugjerim, për çdo vërejtje e cila do të në ndihmonte që ky Raport me qenë sa më gjithëpërfshirës dhe sa më i rregullt. Faleminderit!

Shpetim Hajredini: Përshëndetje të nderuar kolegë/e asambleistë/e, i nderuar Komision, të nderuar qytetarë të Dragashit! I nderuar ekzekutiv, i nderuar kryetar! Ne kur kemi diskutuar në seancën e parë për çështjen e formimit të këtij Komisioni, unë në emër të grupit të partisë pata kërkuar që edhe Asambleja të jetë pjesë e këtij Komisioni. Edhe pse nuk jemi njerëz profesionalë, por së paku të jemi pjesë e atij Komisioni dhe të shohim se si po bëhet vlerësimi i dëmeve të shkaktuara nga vërshimet tek qytetarët e atyre fshatrave të dëmtuara. Dhe, në atë seancë ju nuk e morët parasysh atë propozim tonin, vazhduat me propozimin e juaj dhe vendoset e Komisionin e formuat vetëm nga ekzekutivi. Sot po na vjen vlerësimi i këtij Komisioni, për dëmet e shkaktuara në këto fshatra, të këtyre qytetarëve, dhe sot ne po e diskutojmë vetëm atë të cilën na e keni servue ju përmes këtij Komisioni. Unë absolutisht nuk jam profesional dhe nuk mund të gjykoj se nuk është vlerësuar ndoshta mirë. Apo, nuk mund të them që vlerësimi nuk është i duhur për qytetarët, por pas disa ankesave që kam marrë nga qytetarët, patjetër që më duhet të paraqes para jush se vlerësimi që është bërë në fshatin Kuk për ekonomitë familjare nuk është i duhuri. Unë kërkoj që ky Komision, nëse vetëm kemi hapësirën kohore ligjore, të bëjë edhe një herë rivlerësim dhe të shoh aty ku ka çaluar gjatë vlerësimit të dëmeve të cilat janë shkaktuar në ekonomitë familjare të fshatit Kuk. Natyrisht që lista dy herë na është ndryshue, sot në bazë të fjalimit të kryetarit të Komisionit pamë që ka ndryshim prapë. Andaj, unë e shoh shumë të arsyeshme që të jepet edhe një periudhë kohore, sado që ju e shihni të arsyeshme që nuk do të vonohet për t'u dërguar në qeveri këto dëme të shkaktuara nga vërshimet, dhe të paraqiten të gjitha ato familje për dëmet të cilat janë shkaktuar dhe që në këto momente nuk janë në listën e dëmtimeve. Besoj që është e arsyeshme dhe besoj që kemi mundësi dhe kohën e duhur që ta bëjmë edhe vlerësimin final dhe ta dërgojmë listën

finale tek qeveria, të plotësuar në tërësi. Ju faleminderit!

Driton Ademi: Përshëndetje për të gjithë! Atëherë, nuk do t'i marr disa fjalë të cilat i tha kolega, por nuk bën edhe disa prej tyre pa i thënë. Siç e tha Shpetimi, Komisionin nuk e ka formue ky Kuvend. Po lind pyetja, pse te ky Kuvend me ardhë edhe me u bo ky Raport, na me e votue këtë Raport? Mu po më vjen shumë çudi. Ma së pari na si Komunë nuk kemi buxhet për me jau nda këtyre. Nuk jam kundër për me jau nda, po ne si Komunë nuk kemi buxhet. Çka kemi me votue këtë, edhe ka me shkue në Qeveri? Nuk po e shoh të arsyeshme. Njësoj sikur Komuna me e çue direkt, si Asambleja me e çue direkt. Po në Asamble – na qysh e kemi kërkue në seancën e kaluar – kemi kërkue që të formohet Komisioni. Komisioni prej Kuvendit nuk është formue, mu për çudi po më vjen se prej këtij Kuvendi ne i kemi formue edhe kryetarët e fshatrave. Kryetarët e fshatrave, në lokalitete shumë të pakta janë të përfshirë në këtë Komision. Mungesë e dokumentacioneve tha kryetari i Komisionit. I nderuar, unë nuk e shoh të arsyeshme me thënë mungesë të dokumentacioneve, sidomos te pjesa e diasporës. Vërshimet janë bo në qershor, diaspora ka ardhë në korrik edhe në gusht. Qysh nuk keni mund ju me i sigurue dokumentacionet e tyre? Qekjo është tipike një rrenë, me dalë këtu edhe me thënë që s'kemi mund me i marrë dokumentacionet. Vonesat e ekonomive familjare të këtyre këtu që janë, pse me pas vonesa? Keni dalë nëpër faqë të Komunës, keni deklarue që kemi me dalë si Komision. Pse nuk i keni marrë kryetarët e fshatrave, për atë punë i kemi formue na, edhe me ata me shkue në secilin lokalitet. Ma mirë se ata që i dinë, ju si anëtarë të Komisionit e kryetar, asnjë s'mundeni me i ditë. Po më vjen shumë keq. Mu po më vjen edhe çudi pse brenda dy ditëve me u ndryshue lista. Lista u ndryshue ma shumë – mundem me folë për Bresanë, masi vij veç prej Bresanës – po më vjen shumë mirë që është edhe një anëtar i Bresanës këtu, po me ia nis edhe me emra këtu që janë në Bresanë, është për të ardhë keq. Lista me u ndryshue brenda dy ditëve edhe me i pa emrat këta qytetarë këtu, me i pa emrat kujt janë lëshue edhe sa i janë lëshue, është për të ardhur keq. Mu ma shumë po më vjen puro politike kjo – njësoj sikur kubëzat – si fushatë elektorale. Nuk po due me hy me emra me i pa, po veç po ta marr një shembull të një biznesi, që kam pas këto ditë kontakt me shumicën e qytetarëve. Një biznes, që vetë Komisioni ka qenë te ai biznes, shuma ka kalue mbi 20 mijë euro kur e keni miratue si Komision. Unë sot po e shoh këtu, shuma 14 mijë euro. Pse është ndryshue? Ju kur keni qenë si Komision ia keni shkruar mbi 20 mijë euro, saktë nuk po e di, afër 22 mijë euro më duket. Sot unë po e shoh me 14 mijë euro këtë. Sefo, po foli për Bresanë, kur të dalish për Kosovë mundish me folë. S'kam qef se s'e di çka ka ndodhë nëpër fshatra tjera, veç munda me folë për Bresanë. Mos të foli, disa emra këtu që janë veç për fshatin Bresanë po foli ma shumë, disa emra – pa i përmend – në lagjen e kryetarit që shumë mirë e di që është bë dëm, në pjesën lartë, dëmi më i madh te lagjia kryetari ku banon. Disave u janë ulë çmimet, e disave edhe u janë rrit. Për mu, është e palogjikshme. A kemi këtu hendek, që dikujt nuk iu plotësue sa duhet? Po. Dikujt a i është shkue ma shumë? Edhe qekjo ka ndodhë te qeky Komisioni. Edhe një pyetje e kam për

Komisionin. A do të dilni me këto listat publike, apo na do të dalim me këto listat publike? Domethënë, me i publikue me emra, se shumica, këto tri a katër ditët, se qytetarët e kanë kuptue që keni bo vlerësimin edhe na keni pru në email që ka me u mbajt seanca. Shumica kanë pyet, sa ma kanë vlerësue mu dëmin, sa ma kanë vlerësue mu dëmin, secila ekonomi familjare. Mbi 70% e këtyre që janë në Bresanë, mu më kanë pyet sa ma kanë vlerësue dëmin. Prej 70%-ve që unë po them që më kanë pyet, shumica janë që kanë thënë “shumë pak”. Edhe më e keqja, kur t’i thuesh dikujt – po e marr një shifër – 10 mijë euro, e në fund ju si Komision me ia lëshue 5 mijë euro, po më vjen shumë çudi. Po ka edhe emra, mos të hyjmë ma thellë se bon vaki ... edhe mu uji më ka hy në oborr, po s’kam ardhë me aplikue. Dove iu ka hy uji veç në oborr edhe iu ka shkue në kanalizime, edhe kur po e shoh qetu në listë të emrave që është për çudi. Ose toka bujqësore, ka nashta që i ka marrë me shumica në disa fshatra, disave me nga 5 ari, shumat janë marramendëse. Mu po më vjen shumë për çudi – pres një herë prej Komisionit me ma dhënë një përgjigje. Faleminderit!

Uran Halimi: Përshëndetje, të nderum delegatë dhe të gjithë ju të pranishëm! Po flasim për një çështje pak sa të ndjeshme. Është thirrë seancë e jashtëzakonshme, edhe pse është dashtë me u thirrë seancë e jashtëzakonshme, mirëpo nuk është bërë punë e jashtëzakonshme, saqë ne me e quajt këtë seancë të jashtëzakonshme. Prej kohës së vërshimeve ka kalue diku përafërsisht gati katër muaj, me u pas bo punë e jashtëzakonshme nuk kishte ardhë mas katër muajve këtu në seancë, por është dashtë me ardhë shumë më herët. Edhe pse kryetari tha dy muaj, nuk janë dy muaj, kryetar. Dy muaj janë veç korriku edhe gushti, shtatorin, qershorin edhe tetorin e ke lënë krejt anash. E kemi pas një material të servuar edhe të ndryshuar tri herë, brenda 3-4 ditëve, dhe kjo është arsyeja pse neve si LVV na shtini me reague, me dyshue edhe me hulumtue se çka është duke ndodhë me këtë listë. Vlerësimi i Komisionit, s’mundi me thënë, unë nuk e shoh Komision legjitim sa i përket punës në Kuvend, që ky me ardhë si Komision edhe me u diskutue në Kuvend. Është Komision i formuar jo nga Kuvendi edhe s’besoj, znj.kryesuese, që na kemi të drejtë me u marrë edhe me gjykue punën e këtij Komisioni, ai që mund me gjykue punën e këtij Komisioni është ekzekutivi, kryetari që vetë e ka formue këtë Komision. Siç tha edhe kolegu paraparak, tha na kemi kërkue që pjesë e Komisionit me qenë edhe Asambleja, edhe kishte qenë shumë më transparente, edhe më e duhura edhe kishim pas hapësirë për me diskutue edhe ne si Kuvend për punën e Komisionit, poqëse ishte formuar nga Kuvendi. Ose të paktën, ne si Kuvend kemi pas të drejtë me qenë si mbikëqyrës i këtij Komisioni. Ju aspak që na përfillët. Tha kryetari për reagimin e Qendrës së LVV-së që është reagim i ngutshëm. Nuk e di kryetar, mu më pëlqeu kur e pashë që pas reagimit tonë ke reague edhe ti. Realisht, ka pas diçka aty që t’ka bo me reague gati në mes të natës. Sa i përket qeverisë, vazhdimisht e keni akuzue, po due me e ditë a duhet me i subvencionue këta të prekur qeveria, këto listat që ne i kemi këtu në Kuvend a kanë me u dërgue në qeveri. Thasje me një seancë të mëhershme për atë anëtarin e LVV-së, në vend se me i ndihmue vërshimeve, po merret me akuza. Tash,

kryetar, qeveria duhet me i mbulue këto, e dish ti shumë mirë. Gjithmonë ke qenë mosmirënjohës në raport me qeverinë, edhe pse ke promovue goxha investime të qeverisë si të juajat. Tjetra është që këto lista goxha të manipulume sipas qytetarëve, se prej kohës kur është thirrë seanca e jashtëzakonshme. Shumë qytetarë kanë ardhë në kanë takue, në fakt edhe i kemi takue, na kanë pru informacione. Po mendoj se ka qenë shumë mirë këto lista me i bo publike paraprakisht, me e pas një afat ligjor për ankesa edhe mandej me ardhë si listë përfundimtare. Thaje që nuk është listë përfundimtare, edhe Komisioni tha që nuk është listë përfundimtare, munden me pësue ndryshime. Qysh mundim na me e miratue një listë jo përfundimtare edhe me e dërgue. Tash masi ta miratojmë ajo duhet me qenë listë përfundimtare, a po? Qysh kemi me e ndryshue atë edhe kush e miraton prapë atë, nëse pëson ndryshime? Se na mundim me thënë që e kemi miratue këtë listën, e jo një listë tjetër që ka mundësi me pas ndryshime. Një kërkesë e shefit të GP-së të LVV-së në kohën e vërshimeve ka qenë që na me nda pak mjete, të paktën si Komunë, sa u përket atyre vërshimeve, sidomos në fshatin Kuk edhe në fshatrat tjerë që janë prekur nga këto vërshime. Kryetar as që e përfilli, e me shumë zell edhe vullnet tha që Qeveria asnjë cent nuk e ka ndarë për këto vërshimet. Kryetar, përderisa ti s'ke pas vullnetin me e nda ndonjë cent për këto vërshime, qysh mundesh me e marrë guximin edhe me thënë që Qeveria s'e ndau asnjë cent. Ne ta bëjmë kërkesën në Kuvend për me e nda një shumë, të paktën modeste, edhe me i evitue ato dëmet më urgjente për ato fshatra, mirëpo ti the që nuk ka buxhet në lidhje me këtë. Tash, në fshatin Kuk, Bresanë, Pllajnik e shumë vende tjera, lista është jo e duhura. Jeni mundue edhe ka pas tentativë për diku fryerje të atyre dëmeve, e diku minimizim. Ne jemi pro subvencionimit të dëmeve, si LVV edhe si delegatë të këtij Kuvendi, mirëpo le të subvencionohen meritoret. Kemi individë që dëmet i kanë edhe vetë i kemi pa, dëmet i kanë goxha të mëdha. Ndërsa, parashikimi për mbulueshmëri është goxha i ulët. Me keqardhje e them që kjo është listë për hajgare. Përveç kësaj që po flas, në kohën e vërshimeve kam dalë edhe unë në terren, ani se s'kam bo selfie atje. E kam pa edhe me sytë e mi se çka ka ndodhë, edhe cilat familje janë prek ma shumë. Ne nuk mundemi me e mbështet këtë listë jo përfundimtare, aspak transparente para qytetarit. Nuk ka edhe afat për ankesa, unë s'pashë as në vendim afat të ankesave. Nuk pashë në asnjë material afat për ankesa. Meqenëse na duhet ta votojmë një listë përfundimtare, të cilat janë mundësitë e qytetarëve për me u ankue, ose me i shpreh pakënaqësitë e tyre në raport me këto lista. Unë mendoj që në këtë listë duhet me pas shumë kujdes edhe me e përpilue me mjaft kujdes. Le të vjen një listë përfundimtare. Edhe, kërkesa ime tjetër është që kjo listë duhet me u bo publike. Nëse jo nga ju, atëherë ne do ta publikojmë, kryetar. Le ta shohë qytetari se çfarë liste është bo, cila është vlera e kompensimit te dikush, e te dikush tjetër sa. Kështu që, për transparencë kur të flasim, kjo është listë aspak transparente. Duhet me e pa qytetarët se çka ka ndodhë me këtë listë. Faleminderit!

Nexhat Selaj: Përshëndetje për të gjithë! Përshëndetje, kryetar! Po kthehem pak mbrapa, kryetar, para tri viteve kur e morre mandatin, the se përpos të gjithave do të jem kryetar i të gjithëve. Nuk do të jem kryetar i partisë, po do të jem kryetar i popullatës. Bashkëpunimin, duhesh të jesh shumë transparent, kryetar, bashkëpunimin me partitë politike e ke zero. Gjithaçka çka ne nga opozita flasim, të duket si e shtrembër dhe nuk të duket reale. Po të kishe qenë pak më i përmbajtshëm në ato të cilat ne i diskutuam në seancat paraprake, ku të kërkuam – që nuk dua ta vë në dyshim unë punën e Komisionit – unë jam i sigurt se Komisioni ka bo një punë kolosale, ka bo një punë të ndershme dhe të mirë – po përderisa ne nuk kemi njerëz të cilët të vendoset edhe nga Komisioni se çfarë pune është bo, e jo të shti në dyshim që të është – s’po them 100%, po 99% të është politike. Po të kishte qenë transparent, që nga Kuvendi ta kishim nxjerrë edhe nga një anëtar prej secilës parti politike, jam shumë i sigurt se ky debat nuk do të ishte zhvilluar kaq. Ky do të kishte marrë fund me ato të cilat do t’i servojke vetë Komisioni. Puna e cila është kryer nga Komisioni për këto ditë, unë po besoj se është një punë shumë madhore. Por, ta prezantosh këtu punën e Komisionit – ky është Komision vetëm i ekzekutivit, nuk është Komision i yni. Unë nuk kam qenë në terren, nuk di për këto shifrat. Çfarë të na thoni, ne do të themi po, ose do të themi jo. Po të kishte qenë edhe Kuvendi vetë prezent, do të kishte qenë edhe rrjedhoja e punimeve më mirë, edhe dyshimet do të kishin qenë shumë më të pakta. Kështu që, kjo mostransparencë e juaja, edhe mosbashkëpunimi i juaj, kryetar, me Kuvendin – unë nuk e di. Vetëm trego, ne kemi qenë gjithmonë të gatshëm, sa herë nëpër seanca të kemi thënë, nëpër ato pozicione ku je, kryetar, kur kie nevojën e asambleistëve, duhesh të kuptosh që edhe ne diçka dimë. Ne për ju jemi të pavlefshëm, ne për ju jemi të padijshëm. Gjithçka vendosësh vetë. Kur vendosësh vetë gjithçka, çka na biesh këtë material këtu, me u komprometue ne edhe me ata të cilët kanë pasur këto dëme – të cilat me të vërtet kanë qenë dëme dhe janë dëme për me të ardhë keq. Por ne nuk mund të vendosim për këto. Keni vendos vetë. Kur vendosësh vetë, çka lypish nga ne? Unë kështu e marr: Ne nuk dimë asgjë për vlerësimet. Të lind dyshimi me dyshue gjithçka. Unë nuk po i përmendi me shifra. Ka një mori prej atyre të cilët janë shumë të pakënaqur. Thonë, po të shiqosh të atyre të partisë LDK, asgjë s’i ka bo e ka marrë nga 3-4 mijë. Po unë nuk e di atë, çka flitet në popullatë nuk di. Diçka ka! Po të kishim qenë edhe ne prezentë, nga një anëtar, sigurisht se do të ishin minimizue, s’po them jo, se ne kërkesat e qytetarëve janë shumë më të mëdha sesa të cilët dëmet janë bo. Por, mendimi jem është i gabuar, mendimi jem është i gabuar, të cilët keni vendos ashtu. A, punën e Komisionit do ta çmoj, të cilët kanë punue, po po më doket se puna e tyre është e barabartë me zero. Faleminderit!

Sefidin Mejzini: Kryesuese, faleminderit për fjalën! I nderuar kryetar, të nderuar të pranishëm, përshëndetje për të gjithë! Po e shoh që ka fillue fushata zgjedhore. E falënderoj kolegun, profën Nexhat, për vlerësimin e Komisionit, që nuk është me të njëjtin mendim si Dritoni. Janë të njëjtës parti, por kanë mendime të ndryshme. Driton, a muj me t’u përgjigj tash, se më thaje kur të dalësh këtu. I

thaje Komisionit po rreni! Duhet me iu kërkue falje, se këto nuk janë çipsi, a po i sheh këto dokumentat janë krejt që kanë punue në terren. Njëpër çdo katund e kanë thittë Këshillin e fshatit edhe iu kanë drejtue. Tash ti vetëm mujsh me m'dëgjue, unë të dëgjova. Tash unë t'i shpjegoj krejta për të gjithë, se nuk mundesh me m'dekoncentrue se kam goxha përvoja kështu edhe nuk acarohem sikur ti shpejt, edhe foli me fakte. Është bo një punë goxha e madhe, e tha profi. Ka pakënaqësi, dikush thotë i keni fry. Shpetimi nuk ishte i kënqaur me vlerësimin. Por një send duhet me e ditë: tash hajde po pagun Qeveria, po pagun Komuna, janë disa send që duhet me i marrë parasysh. Hajde t'i fryjmë, e hajde mos t'i fryjmë! Është një Komision, edhe kur thaje çmimin 22 mijë euro, kërkuj këta nuk i kanë dhënë çmim kur kanë shkue me i marrë dëmet. Se këta nuk e bëjnë vlerësimin e dëmit, se janë do eksperta tjerë që i parashohin saktë. Këta vetëm e kanë marrë vlerësimin e dëmeve që janë bo. Nuk i kanë thënë Sef i ke 22 mijë, ose Driton 15 mijë të qenkan bo. Kjo nuk qëndron! Qe ku është Komisioni, kjo nuk qëndron! Jo atë ditë, qysh tha ky, të kuptohemi edhe dëgjoni mirë, se unë jam i mësuem me dëgjue mirë edhe me e bo një vlerësim. Ky zotnia tha që i kanë thënë 22 mijë, masnej 14 mijë. Po nuk të thojnë ata qat ditë, t'i kanë marrë dëmet që janë bo qat ditë. Lypi të kryetari i Komisionit, tha që mungesë. Njerëzit kanë qenë në ankth, s'ka pas kohë ai me marrë telefonin me bo foto kur është bo vërshimi në qato momente. Masnej, janë do sende shume tjera. Po tash nuk është mirë me bo politikë. Ka shumë familje që presin. Nuk bën tash me ju marrë në qafë, se dihet sa familje janë të varfëra, i presin qeto paret me investue në shpi. E tash nuk bën ju me bo politikë në kurriz të atyre. Se edhe në kohën tuaj ka qenë një komision, po na i kemi votue. A i keni fry a s'i keni fry, na e kemi votue, se na ka ardhë keq për familjet. Po të Komunës, edhe këto s'janë as të miat, as të kryetarit, as të kryeministrit, janë të popullit paret. Mos filloni me bo fushatë, se janë familje të varfëra, e presin këtë Komision. Kryetari shumë mirë tha, rekomandim prej qendrës, duhet me e qit në Kuvend, qe e kemi pru në Kuvend. Tash, politikë nuk bën me bo me fatkeqësitë natyrore. Edhe politika e ka njëfarë kufiri, të bërit politikë, e jo si Dritoni. Faleminderit!

Driton Ademi: Sef, edhe një herë po të them, kur të dalish me folë del, del me argumente, ku e pata qëllimin e foljes. Kur thashë te rrena, thashë te mungesa e dokumentacionit te diaspora. Nëse ka ndodhë vërshimi mas 20 qershorit, diaspora ka ardhë mas 10 korrikut. Dëmin a je t'u e pa sot, 14 tetori është. Prej korrik edhe gusht, qysh kanë ardhë të diasporës, s'un ke mund me i gjet ata a? Nëse ti ke qenë në terren? Kjo është nje rrenë e kulluar që ti mu nuk mundesh me ma shit. Pse unë e thashë këtë? Për çka na si Kuvend i kemi formue kryetarët e fshatrave. A bën me e ditë? Ma mirë se një kryetar i fshatit që i di dëmet, nuk munden me i ditë dikush. Ti lë që s'ke formue komision prej Kuvendit, nuk i ke thirrë as kryetarët e fshatrave nuk i ke shti në Komision. Kjo është e palogjikshme për mu. Rekomandim nga qendra. Le të ma bjer kryetari që e ka rekomandimin nga qendra, bjere, se veç me folë kollaj ju e keni. Po thoni rekomandim, bjere atë, bjere këtë. Bjere me letër që e kie. Sikur sot që e keni pru

rekomandimin për QKMF-në, bjerma edhe sot atë, atëherë unë ty të përgjigjem, ndryshe të përgjigjem. E dyta, vlerësimine Komisionit ti thaje. Komisioni, kur ka shkue me e vlerësue, ia ka vlerësue qaq dëmin qatij biznesi, prej fjalëve të biznesit. Unë po foli prej njerit. Nëse vij unë ty me të pyet, ti më ke thënë mu që qeto ma ka vlerësue, është ndryshe. Si Komision, kur ka shkue e ka vlerësue qa. Po pse, a bon me e dit – mos të hyjmë me emra tash – ka dalë emri 15 mijë, sot ty të ka ardhë emri 7 mijë. Pse u ndryshue pra ky, a bon me e dit edhe kjo pse u ndryshue. A po doni me e qit. Po nëse ju nuk e qitni si ekzekutiv, atëherë ne kemi me i qit si parti politike. Edhe te ekonomitë familjare, pse mungesa? Po ta them edhe një çështje, te çështja e bujqësisë, pse nuk janë përfshirë fermerët e fshatit Pllajnik, që ka qenë Komisioni edhe disa prej tyre nuk janë në listë. Tash e mora informacionin se disa prej tyre, fermerë, nuk janë në listë. Nuk po them që këta e kanë neglizhue krejt punën, kanë bo punë të mirë, po me e kqyr me shifra – nuk po i qes unë krejt poshtë, kanë bo punë të mirë – po me pas dashtë, në bashkëpunim me Kuvendin, me anëtarë të Kuvendit, me kryetarë të fshatrave, kishin bo shumë më të mirë edhe s’kishte ardhë puna e diskutimit deri këtu. Faleminderit!

Sefidin Mejzini: Tash, Komisioni ka bo punë të mirë, ama pse jeni ju në qeverisje ne nuk duam me e votue. Kështu po e kuptoj unë. Tash, a i kanë fry, a s’i kanë fry? A i kanë lënë mangu, a s’i kanë lënë mangu? Duhet me e ditë. Kjo po shihet që është shumë politikisht. Ju thashë edhe një herë – emra s’përmenda, ju mundeni me dalë të drejtën me e shfrytëzue sa të doni – thashë janë të pakënaqur, ka plot të pakënaqur, se ka qef hajde edhe nja 10 mijë mos po i marr. Edhe kërë duhet me e pas si bazë ju, kur të delni me diskutue. Me pas qenë krejt në rregull, ju pa e gjet një bisht s’keni pas qare. Se është puna për me e gjet një bisht. Domethënë, ky Komision e ka bo punën shumë mirë, ama pse jeni ju në qeverisje ne nuk duam me e votue. Veç përkundër jush, ne e kemi votue, s’di sa e dish, Shpetim. Një Komision që ka qenë, në Blaç e ku kanë qenë ato vërshimet. Nuk e kemi bo fjalën dy, e kemi ulë kryet, mos me i penalizue familjet e varfëra, ne e kemi votue. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Uran, shumë e rëndë kjo qeshja jote! Jemi mbledhë për një arsye shumë të rëndësishme. Para mediave po bojsh shumë sende të mira, e kështu mas mediave... një femër nuk bën me e buzëqesh qashtu, me qaso mimika. Hera e fundit që po ta tërhek vërejtjen. Tash ta japa fjalën, se emrin ta kam përmend.

Shpetim Hajredini: Koleg i nderuar, diçka m’i preke dy kolegët e mi asambleistë, njëri mirë po fol e tjetri keq. Ama na jemi liberalë, ne nuk e detyrojmë asnjërin, a më ke pa najherë unë që i them najnjonit fol ti qeshtu, ose atij tjetrit bon diçka? Jo! Ka të drejtë secili për mendimin e vet, ne jemi shumë të hapur, ky e ka mendimin e vet, ai tjetri të vetin, unë e kam timin. E sidomos për çështjet shumë të njëshme dhe të rëndësishme, absolutisht nuk bëj politikë unë personalisht kurrë. Beso, Allahi e di nijetin, qëllimin tem, se ti s’mujsh me e dit, e as unë tëndin. Por, nuk e bëj për politikë kurrë. Edhe fjalimin tim në fillim që e pata, e pata të përgjithshëm, nuk synova me e ulë askënd. As Komisionin, e

as ekzekutivin. Normalisht që jap kritika se pse s'na ka pranue në Komision të jemi edhe na prej asambleistëve, prej partive politike. Dhe sot – mirë e tha kolega – që nuk do të kishim diskutue, besoj fuqishëm, nuk do të kishim diskutue fare po të kishim qenë pjesë e Komisionit edhe na. Tjetra, për vlerësimet, unë personalisht i njoh mirë në fshatin Kuk çka ka ndodhë. Nuk kam qenë vetëm me bo foto edhe me ik prej atyhit, po unë kam qenë aty prej fillimit deri në fund edhe i di edhe tash. Ata, pothuajse një përqindje të madhe të atyre dëmeve ata e kanë krye. Mirëpo, vlerësimi që është bo për këto familjet që unë vetë i pashë, me këto shuma, për mu, për mendimin tim nuk është i duhur. Prapë, Komisioni besoj që kanë qenë adekuat dhe kanë vlerësue por, për mendimin tim, nuk është i duhur për disa familje që po i shoh këtu. Dëmet kanë qenë shumë më të mëdha, në krahasim me vlerësimin që është bo. Por, prapë mbetet në ndërgjegjen e tyre edhe një send unë e kam thënë, edhe e them prapë: frigonju Allahut, keni me dhënë llogari para Zotit. Qysh i ke vlerësue qeto shuma ti qetu, këto pare janë të qytetarëve të Kosovës, edhe të qetyne qytetarëve të varfër. Ti e ke vlerësue si duhet, kie me e marrë edhe përgjigjen, edhe lëvdatën prej qytetarëve, po edhe ke me e marrë shpërblimin prej Zotit. E ke vlerësue në të kundërtën, ke bo manipulime, ia pafsh hajrin zotni. Ne do ta votojmë qeshtu qysh është. Edhe unë s'jap llogari as para qytetarit, as para Zotit, se unë s'di çka ka bo ose çka ka ndodhë. Unë muj me e ditë pak në Kuk, në fshatrat tjerë nuk e di. Kjo është ajo që deshta me e thënë. Faleminderit!

Uran Halimi: Deshta me u ndërlidhë pak më herët edhe me kolegët paraprakë që folën. Po mirë që ma përmendet emrin. Tash gjendja jeme emocionale ajte në vend ndryshon herë pas here. Ndonjëherë më vjen me kesh, ndonjëherë s'më vjen me kesh, znj.kryesuese. Arsyen edhe qëllimin pse unë kam kesh, ti s'mundesh me e ditë. Edhe me m'nënçmue në qat nivel është e ulët. Për shembull, dikujt i keshet për arsyet e veta personale, unë muj me kesh, muj edhe mos me kesh. Tash pse po keshem unë, s'e di pse po të pengon. Kqyre dikë tjetër që s'keshet, nëse e ke çështjen shumë serioze. Znj. Kryesuese, jemi për me u kesh vallahe. Jeni! Ju veten po e boni që na me u kesh. Ne shumë qartë e kemi thënë edhe po e themi që nuk është Komision që ne e kemi formue edhe çka të diskutojmë në lidhje me këtë? Kah mos me u kesh na aty? Pse s'keni formue komision të Kuvendit? Këshillat e fshatrave i përmendi janë thirrë tha Këshillat e fshatrave. Nuk janë thirrë Këshillat e fshatrave. Se me u pas thirrë Këshillat e fshatrave, na nuk kishim pas as ankesa sot, as nuk kishim pas të drejtë me dalë me folë. Nuk janë thirrë Këshillat e fshatrave. Ka mund kryetari, në mesin e Komisionit, aty kur i ka qit emrat te lista e Komisionit, ka mund me thënë: për filan fshatin, ta zëmë, është filani komisioner, në bashkëpunim me Këshillin e fshatrave. Kërkund nuk i keni përmend këshillat e fshatrave, sot po dilni këtu, këshillat e fshatrave. Thaje ka fillue fushata. Po vallahe po. Për vlerën që e kemi pa aty nëpër lista, përtej fushatës jeni, ka fillue blerja bile, jo fushata. Te ju blerja ka fillue, sa i përket listës. Po po, shumë e vërtetë është kjo. Qytetarët po e thojnë këtë. Se Komisioni juaj e ka pru një listë që i ka ngjallë reagimet e qytetarëve dhe na kanë gjet neve, se ata s'mundin këtu me ardhë me folë. Edhe nuk i ke publikue paraprakisht listat,

që ata me hi edhe me ardhe me t'u ankue ty në Komunë. Ti veç e ke pru një listë të ndryshume brenda tri ditëve tri herë, edhe tash po thotë kryetari nuk është listë vendimtare. Qysh ta votojmë na një listë jovendimtare, një listë të një Komisioni që ne nuk e kemi zgjedhë. Ne nuk kemi të drejtë ligjore për me e votue qat listën e këtij Komisionit. Sa i përket Kuvendit dhe punës së Kuvendit, znj.kryesuese, Komisioni është jolegjitim në lidhje me Kuvendin. Komisioni munden me qenë legjitim sa i përket ekzekutivit. S'po them që nuk kanë bo punë, kanë bo punë se janë marrë me ato, kqyre gjithë ato dosje i kanë servue këtu. Ama na emra nuk përmendin, o i nderum. Se e di ku e keni qëllimin, që na me përmend emra, me dalë keq para qytetarëve. Qitni bre emrat, ju i keni përmend emrat. Qitni qata emra që i keni përmend, që i kemi në këto lista, jep hapësirë kohore për ankesa, për pakënaqësi. Qysh ke pru listë përfundimtare, kur s'ke pas afat të ankesave. Ku e dinë ata sa i ke financue edhe sa i ke mbulue dëmet. Cili qytetar sot e di se sa pare i ke lëshue? A e din 100% të listës?

Jetmir Ajdini: Përshëndetje për të gjithë! Sot jemi mbledhë të diskutojmë për një çështje shumë të rëndësishme edhe shumë të ndjeshme që e ka prek Komunën tonë para më shumë se tre muaje. Jemi mbledhë të diskutojmë për një punë të një Komisioni të cilin nuk e kemi formue na, e ka formue ekzekutivi komunal. Komisioni ka ardhë me punën e vet, me punën që e ka bo përreth tre muaj. Mendoj që është punë e vonuar. Është dashtë të kryhet shumë më herët edhe shumë më shpejt, edhe të vijnë me vlerësimin përfundimtar shumë më shpejt. Çka doja të thoja sot, e kisha një kërkesë për të gjithë anëtarët e Kuvendit Komunal, që të marrim një vendim si Asamble Komunale, që këto lista së pari të publikohen, qytetarët të kenë qasje në këto lista, t'u jepet një afat për ankesa, sado që e vlerëson Komisioni, 2-3 javor, që qytetarët të kenë mundësi të bijnë dokumentacion edhe të ankohen për ato shkelje që ata mendojn që janë bo, për arsye se një pjesë e qytetarëve të cilët kanë pas qasje në këto lista, përmes neve, vlerësimi nuk është adekuat. Për atë, i kërkoj kësaj Asambleje Komunale që të marrin një vendim që këto lista të bëhen publike, qytetarëve t'u jepet një afat ligjor, 2-3 javë, sado që e vlerëson Komisioni që munden me e krye atë punë. Edhe gjithashtu, ky Komision të mbikëqyrët prej Kuvendit Komunal, secila parti politike me nga një anëtar, edhe bashkërisht të vijmë në lista përfundimtare, të bëhet vlerësim real i dëmeve, të bëhet kompenzim real i dëmeve të cilat i kana shkaktue vërshimet, edhe qytetarët të kompenzohen për çdo cent që është humb edhe është shkatërrue ekonomia e tyre familjare, dëmet në bujqësi e të gjitha këto. Mendoj që është një kërkesë shumë legjitime edhe shumë e drejtë. Kështu që, besoj që secili jeni pro kësaj kërkesë të cilën e bëra. Faleminderit!

Nedžmidin Sejdilar: Ne nuk jemi në shkollë këtu dhe mekanizmat politikë janë shumë më të mëdhenj se sa të provokosh nga ulse. Nuk mund të jesh kaq arrogante me mua. Kudo që shkoj e mbaj me vete dinjitetin tim dhe e mbroj. Të lutem më respekto me mirësi. Menjëherë pas përmbytjeve, nga kjo foltore kërkuam që Kuvendi të formojë një komision, i cili do të shqyrtojë të gjitha pretendimet dhe të bëjë një

listë. Atëherë ju kryetar e hodhët poshtë një komision të tillë, sepse thatë se i zgjidhni vetëm problemet e qytetarëve. Tani që keni ardhur në qorrsokak, na keni sjellë një komision në kuvend për t'ju larë. Një vendim të tillë e morëm në komision. Ju nuk keni dashur të formoni një komision të tillë. Mund të kishit shpallur gjendje të jashtëzakonshme. Tani pas 4 muajsh na jepni patate të nxehta. Unë i mbështes të gjitha subvencionet sepse ne jemi këtu për të mbështetur qytetarët tanë.

Samidin Xheladini: Të nderuar të pranishëm, ju përshëndes të gjithëve! Ne këtu jemi në një seancë solemne, sepse dëmet janë voluminoze, dhe në pamundësi pët t'i përballuar Komuna, Qeveria Komunale e ka parapa për shkak të mungesës së mjeteve, këto mjete t'i kërkojë nga Qeveria qendrore. Ne jemi këtu për me bo vetëm punë të mira. Unë së pari falënderoj Komisionin, dhe e përshëndes për punën voluminoze dhe shumë të mirë që e ka bo, e kanë dhënë një kontribut maksimal për sanimin e dëmeve dhe kompenzimin që do t'u bëhet njerëzve që janë të dëmtuar. Unë po i shoh do subjekte politike këtu që e ngrenë zërin, me argumente ose pa, por një gjë duhet ta dimë: Rregullat e lojës nuk duhet të ndryshojnë, se ligjet janë në fuqi dhe nuk ka të bëjë aty se kush është kryetar, ka të bëjë se kush duhet t'i zbatojë ligjet. Edhe kryetari edhe na duhet t'i zbatojmë të gjithë. PDK-së po ia rikujtoj që është dashtë të konsultohen me ish-kryetarin Shaban Shabani. Se nuk jeni konsultue ju fare. Kemi pas vërshime në kohën e tij dhe ka qenë dashtë të merrni sugjerime nga ai. Ai sigurisht nuk do t'ju lënte juve me ra në lajthitje. Nuk jeni konsultue, as nuk e keni bisedue, as nuk e keni fute për një çështje kaq serioze me u marrë. Jam i bindur, se derisa diskutimet po rrjedhin në këtë formë, unë po e shoh që Kryetari Shaban Shabani nuk është pjesë e lojës. Ai ju kishte sugjerue edhe ju kishte treguar saktë – se i di ligjet dhe i di krejt rregullat ma mirë se na, ma mirë se unë edhe ma mirë se ju. Prandaj, ju kisha bo apel që të konsultoni njerëzi ose ish-kryetarët, ose njerëzit të cilët janë marrë me këtë punë në Komunë. Ne këtu jemi për me i përmirësue gabimet, edhe Komisioni. Me dhënë sugjerime, me dhënë vërejtje, me kqyr a ka gabime. Unë dy raste i kam, një bile të fshatit Kuk, rastësisht më tregoi se nuk është vlerësue dëmi si duhet. Unë nuk kam me e përmend emrin, por në qoftë se ka nevojë, edhe atij vendasit tem nëse ka nevojë ia përmendi emrin, se atij janë vlerësue pak më shumë se që duhet prej Komisionit, por tash Komisioni i ka argumentet dhe dsëshmitë e veta pse u vlerësue. Dhe ti zotëri – s'po ta përmendi emrin se dalish me folë, por konsultohu për të VV-së, konsultohuni edhe ju me Kryeministrin dhe me njerëzit e Qeverisë, bisedoni, se si duhet në këso raste t'i ndihmohet popullatës. Si duhet me i ndihmue, e jo me e pengue popullatën, mos me u realizue këto. Pyetni në Qeveri, qysh duhet për vërshimet me veprue ne si Asamble ose si qeveri. Faleminderit!

Artan Loshaj: Përshëndetje për të gjithë! Shumë nga fjalimi u morën edhe nga kolegët më herët, edhe ata i mbështes për arsye se u dashtë qysh në fillim të kemi edhe ne anëtarë nga Kuvendi, e jo të na servohet një dokument nga ekzekutivi. z.Sef, sefte me ty si shok kështu, po shumë e bone avokatin e Komisionit, duhet kryetari me dalë e jo delegati. Se këtë Komision e ka bo ekzekutivi, e jo Kuvendi.

Ta kishim bo na është dashtë me e mbrojt ti, po ne jse. E dyta, sa për me pyet kryetarin Shaban Shabani, ju merreni me partinë e juaj, mos u xiglioni shumë kah na se nuk ju del mirë, se nuk bën me u marrë me ne, merrni me ju. Së pari, mu më vjen keq pse ka ndodhë kjo fatkeqësi edhe shqyrr që nuk ka pas fatkeqësi në njerëz po veç në dëme materiale. Unë due me e pyet kryesuesen, pse mas 4-5 muajve me u mbajt mbledhje e jashtëzakonshme, kur nuk kemi na asnjë anëtar nga Kuvendi po ekzekutivi. E dyta, kryetari ma herët tha që nuk është listë përfundimtare, është dashtë me ardhë në Kuvend. A do të jetë listë përfundimtare, kryetar, masi të votohet? Atëherë, pse e keni pru në Kuvend këtë, kur nuk është listë përfundimtare. Ke shumë qytetarë të fshatit Pllajnik, t'u ardhë në Kuvend i pashë t'u i bo do kopje, jo me ngjyra po na lypin e jo pa ngjyra. Hajt se na këtë e çojmë veç sa për sy e faqe në Kuvend, se me Kuvendin bojmë lojë, e masi ta votojë Kuvendi këtë, na do t'ju shtimë në listë. Ke plot qytetarë që janë t'u prit jashtë, pasi të del Komisioni me e pru dokumentacionin shtesë për me e fut në këtë listë. Nëse nuk është e vërtetë, le të ma demantojnë Komisioni. Plot qytetarë të fshatit Pllajnik ke nëpër Dragash, me dokumentacione në dorë që po presin masi të votohet, masi të bëhet loja këtu me Kuvendin. Na çka kemi këtu, çfarë përgjegjësi ka Kuvendi me e votue. Edhe masi të votohet, ju do t'i futni ata qytetarë në lista, të cilët janë duke prit në hyrje të Komunës. Kjo është për me të ardhë keq, po këtë di veç LDK-ja me e bo, edhe thatë fushata, nime fushatën shumë herët e keni nis, po më vjen keq edhe një herë, i keni fry këto lista, disave ju keni dhënë shumë e disave qysh e keni marak ju. Po më vjen keq! Ju thashë edhe një herë, qytetarët janë t'u prit, më kallxoni masi ta votojmë, kryesuese, masi të votohet, qysh do të mundim na me i shti në listë ata qytetarët që janë t'u prit poshtë. Unë kisha propozue që, kur keni prit 4-5 muaj, edhe e keni bo shumë politike e mediatike – 5 muaj keni prit, e keni bo gjendje e jashtëzakonshme, çfarë gjendje e jashtëzakonshme me votue, e kishit pru në seancë të rregullt. Mbledhje e jashtëzakonshme, sikur ajo pula kur e bon një vo, edhe me marrë vesh krejt katundi.

Agron Gashi: Së pari ju përshëndes të pranishëm! Një përshëndetje e veçantë për Komisionin i cili, disa muaj ka dalë në terren për të bërë verifikimin e dëmeve materiale dhe ekonomike që u janë shkaktuar familjeve nga dukuritë natyrore. Duke u nisur nga ngrohja globale, ne jemi dëshmitarë para mediave, jemi duke e parë Bosnjën se sa popullatë humbi në këto vërshime kohët e fundit. Vlorën legjendare e cila u përmbys e tëra nga uji, po edhe shumë qytete të tjera, e shtete të tjera të cilat vërtet janë duke u përballur me një ndryshim klimatik, e cila na përcjell një mesazh, që ne duhet të jemi më vigjilentë dhe të marrim masa preventive pa ndodhur gjërat, sepse vërtet ne duhet të intervenojmë në disa vende, lokacione, në të cilat mund të evidetojmë mos të bëhen dëme kaq të mëdha. Marrë parasysh ditët kur ndodhën këto vërshime, para mediave ke qenë prezent, kryetar, për të ndarë dhimbjen me ta, për të ndarë gjithë kontributin tënd për t'iu ndihmuar. Unë kam parë dhe rrugë me barriera, të cilat janë bllokuar nga vërshimet. Por, edhe nga kjo foltore i përshëndes të gjithë të gjitha ato kompani të cilat kanë dalur për t'i hapur rrugët, ato barriera, të cilat vërtet kanë qenë shqetësuese. Në këtë dua të them

edhe më tej se dëmet kapin vlerën afërsisht 700 mijë euro. Por, apel nga këtu Ministrisë, edhe z.Kurti ka qenë në ditën e dytë për të parë se çka ka ndodhur në këtë vend. Apel MAPL-së që një ditë e më herët të merren masa dhe, nga Komisioni kjo kërkesë që po bëhet t'u lëshohen mjetet, sepse ne, duke u bazuar se jemi vend rural, me nje lartësi mbidetare mbi 1300 m, vërtet temperaturat kanë rënë dhe acari po afrohet, dhe disa familje kanë vërtet nevojë për intervenim sa më parë, me qëllim që dimri të jetë pak më i butë për ato familje. Në kuadër të kësaj, dua të them se edhe familja Reka në rastin e 2011-tës apo nuk e di saktë në cilin vit ishte, ku familja Reka dhe ajo lagje me më shumë se 10 shtëpi u përmbytën nga orteku. Gjithashtu, pësuan edhe dëme në njerëz. Kjo erdhi si pasojë, duke mos marrë masa preventive për t'i pyllëzuar ato zig-zage, ato betonazhe, për të stopuar ndodhitë natyrore. Dhe nga kjo dua të them, Drejtori për Zhvillim Rural, ekspertë të lëmive, të dilet për çdo fshata të bëhet studimi që të mos ndodh më e keqja e mundshme, po para kohe të merren masa në ato vende ku duhet të intervenohet. Po ndoshta edhe tek pjesa juaj ku ka ndodhur është dashtë të ketë disa pyllëzime, disa betonime të cilat ndalin hovin e dukurive natyrore që po vijnë. Dhe gjithashtu, dua të them, të përcjell një mesazh të qytetarët, ato ujëra që janë, ato lume që i kemi, të mirëmbahen, të jemi të kujdesshëm, se ka zëra për mospërkujdesje të lumit, hedhin mbeturina, ndonjëherë ai lumë di të mallkojë, di të bëjë edhe dëme materiale, falë Zotit nuk ka bërë sepse mund të bëjë dëme edhe në njerëz. Tjetër dua të them që ne, një ditë e më parë, edhe juve drejtoritë përkatëse, po sugjeroj që të dilni dhe të bëni studime të mirëfillta, që të intervenohet në disa vende. Unë kam evidentuar edhe në fshatin tim, që çdo reshje edhe e paktë që bjer, kemi familje të cilat kanë dëme materiale në elektrotëknikë, si të thuash, por edhe ne oborre, edhe lagjja aty vërtet është e rrezikuar nga mosintervenimi. Ajo familje ka kërkuar ndihmë disa herë këtu. Por, edhe rrugë të tjera të cilat kërkojnë disa betonime, të cilat edhe lidhin fshat me fshat, Brezne dhe Buqe. Andaj, nga këto dua të them se një ditë e më herët të marrim masa preventive, pa ndodhur gjërat. Faleminderit shumë!

Mehmet Spahiu: Faleminderit, kryesuese! Përshëndetje kryetar, asambleistë/e, qytetarë të nderuar! Unë, si këshilltar më i vjetër i Asamblesë Komunale, shpeshherë kam hezitur të dal të marr fjalën, ngase në baza të asaj që është folur këtu, nuk kam dashur të dal dhe t'i ofendoj kolegët asambleistë. Për arsye se shumë prej kolegëve të mi kanë kërkuar, në një formë, ofendimet. Por, nuk kam dashur t'i qes kurrë në pozita të palakmueshme. Unë shpreh një falënderim në rastin e mbledhjes së sotme, për Komisionin Komunal i cili, në bazë të vlerësimeve të materialeve të dorëzuara, ka bërë një punë kolosale në kryerjen e funksioneve dhe detyrave të marra nga kryetari i Komunës. I shpreh edhe një falënderim kryetarit të Komunës që është përcaktuar për një Komision profesionist i cili ka ardhë nga Komuna, ngase po të formohej nga Asambleja Komunale, unë druaj se ndonjëri prej nesh do të kishte pasur guximin të merrte detyrime. Unë personalisht nuk kisha mundur të marr një detyrim të tillë, ngase nuk jam profesionist i një lëmie për të përcaktuar dëmet e shkaktuara nga vërshimet e para katër muajve.

Konsiderojnë e ne si Asamble nuk duhet të vonohemi për vendosjen dhe ndërmarrjen e masave që këto lista sa më parë të shkojnë në Qeveri dhe të paguhet borxhi ndaj atyre qytetarëve të cilët mezi e presin kompenzimin për dëmet e shkaktuara nga vërshimet. Unë tash nuk di a ka mundësi ligjore, por ju asambleistët që me qindra raste janë përmend aty, edhe ju po i dini të gjitha rastet, nëse ka mundësi ligjore, këta që shprehën rezervat e tyre, po të ketë ndonjë rast që është lëshue, le t'ia bien të dhënat Komisionit dhe le të jetë pjesë e kësaj liste të cilën do ta miratojmë ne sot. Unë ftoj kolegët që këtë listë ta votojnë, që sa më parë qytetarët të kompenzohen për dëmet e shkaktuara. Faleminderit!

Artan Loshaj: Pasi z.Mehmet Spahiu në fund deklaroi që kush ka pakënaqësi le ta bjer listën. Unë ma herët ju thashë edhe nuk mora përgjigje. Plot qytetarë të Komunës së Dragashit, të fshatit Pllajnik, i ke jashtë. A do të futen ata qytetarë në listë, se vetë zyrtarët iu kanë thënë shkoni boni kopje me ngjyra, shkoni plotësoni materialt edhe i bini, do t'i futim në listë. Në qoftë se, edhe ata qytetarë të cilët janë të pakënaqur dhe vetë Komisioni iu ka thënë me pru dokumentacion, në qoftë se i futim në listë ata, atëherë do të shtyhet kjo. A, në qoftë se votohet edhe nuk kemi mundësi të futen ata në listë, unë do të jam kundër.

Jetmir Ajdini: Atëherë, kryetar, pasi që vetë e ke formue këtë Komision, të bëra një kërkesë të vetme. Qeqy Komision ta bëjë publike qat listë të dëmeve me të cilën ka ardhë në përfundim. T'u jepet një afat ligjor qytetarëve të ankohen, të bien ankesat e tyre, edhe secili nga anëtarët e Kuvendit Komunal, nga partitë politike, të jetë pjesë e mbikëqyrjes së këtij Komisioni, edhe të vijmë me një listë përfundimtare, reale, që të bëhet vlerësim dhe kompenzim reale i dëmeve të atyre qytetarëve. Po e sheh edhe vetë që shumica e asambleistëve të cilët kanë pas qasje në dokument, kanë diskutue me qytetarë, vlerësimi po del që nuk është real. Për atë po ta bëj këtë kërkesë shumë legjitime, shumë thjesht, që qytetarët të kompenzohen realisht, sa është bërë dëm. Faleminderit!

Shpetim Hajredini: Besoj që është shumë më e arsyeshme që të shkojmë me një pauzë të shkurtë, dhe ekzekutivi të sjellë listën complete në total që ta kemi, të qytetarëve, me ndryshime – nëse i merrni parasysh ndryshimet të cilat i kërkojnë tash ata qytetarë edhe nëse janë pjesë e asaj liste, dhe të kthehemi pastaj dhe ta votojmë apo jo. Besoj se është shumë e arsyeshme. Përndryshe, nëse ne e votojmë këtë listë që na është servue tani, që e kemi tani, atëherë nuk e di ju ligjërisht si do të keni mundësi ta ndryshoni pastaj. Por ne vetëm po e votojmë këtë listë, me këta qytetarë dhe me këto dëme të cilat janë vlerësuar nga Komisioni. Ju faleminderit!

Driton Ademi: Atëherë, masi e tha veç Shpetimi, që të kërkojmë një pauzë për plotësimin e kësaj listës, se na s'kemi qysh e votojmë, ose këta personat që i kanë dorëzue – me sa mora informacion – sot disa persona që i kanë dorëzue, nëse nuk i votojmë në këtë seancë, atëherë s'mundin me hy këtu këta. Domethënë, të vjen me dokumentacion të plotë, masi tha edhe kryetari që kanë ardhë sot. Propozimi im është me u publikue kjo listë, është mirë që sot me u publikue dhe të jepet një afat trejavor, këtij

Komisionit, pas plotësimit, që qytetarët t'i kenë ankesat e veta, nëse ka dikush, për ndonjë parregullsi që i është bo ndonjë qytetari, pa marrë parasysh. Edhe besoj që, pas dy-tri jave, kur ta shohë Komisioni të arsyeshme, mas dy-tri jave, është ma mirë me e plotësue listën komplet, saqë shkon kjo listë e dalim të pakënaqur, edhe na si Kuvend që e kemi miratue, po edhe ju si qeverisje lokale.

Agron Gashi: Me shumë vëmendje i dëgjova kolegët paraprakë, lidhur me kërkesat e tyre. Unë po konsideroj se ndryshimet nuk ndodhin Ad hoc, këto janë ndryshime të listave të cilat kërkohen, ato kërkojnë kohë, analizë, kërkojnë shqyrtim, të cilat medoemos, të jemi të pajtimit, duhet që të shtyhet për një afat të shkurtër, jo shumë të gjatë, se dimir po afrohet dhe temperaturat kanë rënë. Përndryshe, ndryshimi i listës siç mendohet, është pak e palogjikshme, shkurt e thjesht. Faleminderit!

Uran Halimi: E shterua shumicën e debateve. Sa i përket Komisionit, z.Spahiu tha që ne s'jemi profesionist në lidhje me këtë lëmi, për me marrë pjesë. Meqenëse ne s'jemi profesionist, dikush po ankohet te na joprofesionistët edhe duhet me i pru ankesat këtu, meqenëse Komisionin e keni tepër profesionist. Nuk mundim ne me votue diçka të Komisionit që s' përket Kuvendit, e thashë edhe ma herët, po nuk mundim na me e votue një punë që i përket qeverisë. Na kanë pru këtë pikë të rendit të ditës me na komprometue këtu përpara qytetarit – që na çka po bëjmë edhe çka apo bën opozita. Keni kërkesa, znj.kryesuese, që me u shty kjo pikë e rendit të ditës, me iu dhënë afat qytetarëve. Nuk mundim me e ndryshue nëse e votojmë, edhe ata qytetarët që janë duke prit jashtë, që tha Artani, nëse na veç e miratojmë këtë listë – se duhet me qenë përfundimtare pas miratimit – nuk mundim me e ndryshue na, po u hyjmë ndër hak njerëzve që janë duke prit për me sjellë dokumentacion edhe me u subvencionue për dëmet. Është çështje e ndjeshme, ju e kuptoni edhe na krejt e kuptojmë se u konë fatkeqësi edhe emocionalisht s'jemi ndie mirë kur i kemi pa njerëzit në atë gjendje qysh ka qenë. Ama na jemi duke luajt me ndjenjat e tyre, me gjendjen emocionale që ata e kanë përjetue në fund të qershorit. Qysh kemi me i lënë jashtë listës dikush që realisht është i dëmtuar. Nuk ka afat për ankesa, nuk ka transparencë, kërkush nuk e di sa është subvencionue, kjo është absurde. Ne nuk mundim me e mbështet një vendim që zero transparent. Faleminderit shumë!

Sefidin Mejzini: Nuk pajtohem me kolegun që tha na nuk mujm me e votue. Na deri tash – qe tri vite nuk e di që kemi naj komision që i kemi votue na. Ligjet që na kanë ardhë, pikat e rendit të ditës, statuti i QKMF-së e të gjitha këto, ka kush i bon. Tash, në cilin komision na kemi marrë pjesë që e kemi votue. Krejta që na kanë ardhë qe tri vite? Nuk qëndron kjo! Kjo është me pretekst vetëm me e neglizhue punën. Unë ju thashë në fillim, e keni marrë politikisht që në fillim. Nuk është në rregull. Po në cilin komision ti me mu ke marrë pjesë që e kemi votue na? Po deri tash që i kemi kalue të gjitha ligjet që i kemi votue, ku ke marrë pjesë me gjithë mu? Nuk ke marrë kërkund. Mos, të lutem!

Arijeta Skeraj: Atëherë, i ndërpres të gjitha diskutimet, janë krye, po e marr fjalën vetë!

Disa nga asambleistët kërkuan që pse e keni caktue këtë mbledhje të jashtëzakonshme. Qysh në fillim

të fjalimit e thashë që e kemi prit raportin e Komisionit që është zgjedhë. Disa nga asambleistët kërkuan që në Komision të futen anëtarët e Kuvendit. Unë si kryesuese kam qenë anëtare e Shtabit dhe kam kërkuar që të jenë nga Kuvendi dy apo më tepër anëtarë. Kryesuesi i Komisionit i nivelit qendror ka thënë që është e përcaktuar me ligj kush ka me qenë pjesë e atij Komisionit. Ne, si anëtarë të Kuvendit, u dashtë me dalë edhe me i mbikëqyr. Nuk do të thotë që ja me qenë në Komision, ja mos me qenë. Por, s'besoj që ndonjëri prej Komisionit neve nuk na ka lënë të marrim pjesë. Pasi ishte kërkesa që disa nuk janë të futur në listë, ose u fry ose është largue. Unë kisha pas qef një përgjigje me ma dhënë kryetari i Komunës, ose kryetari i Komisionit. Ka disa persona që nuk janë të futur në atë listë, a do të futen në listë pasi të miratohet apo jo? Sa për sjelljet e mia, ato janë reciproke, qysh të silllesh, do të sillem. Kështu që mos u merr me sjelljet e mia. Ndoshta na di neve Komuna e Dragashit cili jemi më të sjellshëm, edhe cili nuk jemi. Sa për të qeshurën, ne nuk jemi bo për t'u qesh. Ndoshta kemi merita të mëdha shumë si Kuvend, si kam hy kryesuese unë, për tetët muaj 18% kemi pas ngritje sipas KDI-së. E mos të flas punës së ekzekutivit. Faleminderit!

Bexhet Xheladini: Të nderuar delegatë, ju falënderoj të gjithëve për pjesëmarrjen në debatin për një pikë shumë të rëndësishme. Vlersëimi i dëmeve të shkaktuara nga vërshimet. Unë me vëmendje i dëgjova të gjitha vërejtjet, sugjerimet dhe kërkesat që i bëtë. Do të mundohem që të gjithëve t'ju përgjigjem. Sa i përket asaj që thashë në fillim të diskutimit që kjo listë nuk është përfundimtare, listën përfundimtare dhe formën ligjore e merr kur të votohet në Asamble. Kjo pikë e rendit të ditës duhet të kryhet sot, e votoni apo jo është në dorën tuaj. Pastaj, kjo listë përfundimtare, pasi të votohet i çohet qeverisë. I çohet edhe në kopje elektronike edhe në kopje fizike. Vërtet i çohet Komisionit Qendror. Unë edhe në fillim thashë, kur është formue Komisioni, e kam thirrë kryetarin e Komisionit të nivelit qendror me na udhëzue qysh formohet Komisioni, për arsye se nuk kemi pas përvojë në këtë drejtim. Në atë takim ka marrë pjesë edhe kryesuesja si anëtare e Shtabit Emergjent. Ne Komisionin e kemi formuar në bazë të kësaj Rregulloreje, që e kam unë para këtu. Rregullore QRK Nr.17/2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera. Kapitulli II – Organet që bëjnë vlerësimin e dëmeve, Neni VIII: Nenin VIII flet për Komisionin qendror edhe Komisionin Komunal, unë po e citoj vetëm formimin e Komisionit Komunal. Komisioni lokal për Vlerësimin e Dëmeve të cilin e themelon kryetari i Komunës, me propozimin e drejtorisë përgjegjëse për menaxhimin emergjent, në konsultim me drejtoritë tjera. Në rastin e përcaktimit të përbërjes së komisioneve, nga Paragrafi 2 i këtij Neni: Nëse organi kompetent e vlerëson të nevojshme përbërjen e komisioneve, përcaktohet në bashkëpunim me ASK-në. Neni IX, përbërja e Komisionit: Anëtarët e Komisionit nga Paragrafi 1 këtij neni caktohen personat me përgatitje superiore universitare në fushën e ndërtimitarisë, bujqësisë, makinerisë, gjeologjisë dhe ekonomisë, si dhe personat tjerë të fushave përkatëse. Pastaj thotë që nëse komunat nuk kanë persona me përgatitje superiore, atëherë mund të

caktojë anëtarë të komisionit me shkollë të mesme. Gjithashtu, këtu në ligj shkruan që duhet të jetë prej pesë anëtarëve. Ne atë ditë, ne prezencën e kryetarit të Komisionit qendror e kemi formue Komisionin. Pjesë e Komisionit nuk kanë të drejtë me qenë anëtarët e Kuvendit. Decidiv shkruan në Rregullore. Kryesuesja e Kuvendit në atë mbledhje ka kërkuar me mirëkuptim që në Komision të futen dy anëtarë të Kuvendit. Kryetari i Komisionit tha lexone që nuk e lejon Rregullorja. Kuvendi ia jep vulën përfundimtare Komisionit edhe listës. Kështu që, sa i përket Komisionit, besoj që dilemat u hoqën nga ana juaj. Unë po them si është ligji, nëse dikush nuk beson, që unë Rregulloren po jua jap, që Shpetim, merre! Unë e falënderoj z.Lajqi, i cili dy herë ka qenë këtu, ka gjet mirëkuptim, edhe ka ardhë na ka ndihmue. U bë pyetja se pse Komuna nuk ka nda mjete për vërshimet. Dua të ju informoj juve se Komuna ka ndarë 259 mijë euro për mbulimin e dëmeve që janë shkaktuar në infrastrukturë publike. Kemi anuluar tenderin 60 mijë euro i cili ka qenë i paraparë për renovimin e Komunës; kemi anulue tenderin për renovimin e ish-objektit të DKA-së; kemi marrë mjete të cilat kanë qenë të parapara për blerjen e naftës; kemi bërë reduktim të blerjes së naftës. Kështu që ne kemi paraparë 259 mijë euro nga Mallrat dhe Shërbimet. Këto shënime i mora unë tash nga Zyra e Prokurimit. Unë kam prit që Qeveria do të reagojë pozitivisht dhe do të ndajë mjete. Ne kemi prit afër dy muaj mos po na jep Qeveria mjete, atëherë jemi mundue edhe i kemi gjet këto mjete, i kemi reduktue edhe shpenzimet e çdo drejtorati. Kemi pas të programuar me ble kompjutera, i kemi reduktue edhe nga ato mjete i kemi ndarë 295 mijë euro. Janë shpallë disa tender, vetëm një tender – një kompani është ankue në OShP, presim që këtë javë edhe ajo të zhblokohet. Vlerësimi i dëmeve është diku afër 550 mijë, ne kemi pas mundësi me i nda veç këto 295 mijë euro. Unë si kryetar i Komunës, disa herë Komisioni Komunal është mbledhë, dhe çdo herë, në fillim të mbledhjes kam marrë pjesë edhe unë. Edhe kam kërkuar nga anëtarët e Komisionit që mos të bëhet fryrja e vlerësimeve, por as minimizimi i tyre; të mos mbetet asnjë person i cili ka pësue dëme pa u fut në listë. Gjithashtu, kam kërkuar që të bëhet një vlerësim real dhe që për çdo dëm që është bërë, të gjithë anëtarët e Komisionit të merren vesh, ta bëjnë një çmim unikat. Për shembull, nëse dikujt i është dëmtue mashina e larjes, jo dikush me e vlerësue 300 euro e dikush 200, po të gjithë me e vlerësue me të njëjtin çmim. Editimi i listës është bërë për këtë arsye, se disa anëtarë të Komisionit kanë mund me e vlerësue një artikull që është dëmtuar më shumë, disa ma pak. Për atë Komisioni është takue, edhe e kanë marrë një çmim mesatar, për shembull për mashinën e lamjes, për një burmashinë etj. Unë nuk po them se Komisioni nuk ka mujt me gabue – se edhe Komisioni është njeri, nuk është robot mos me gabue, mund të bëjë edhe ndonjë ndryshim. E për atë jeni edhe ju këtu të cilët, e di që disa keni dalë në terren, keni hulumtue, disa kanë marrë rolin edhe të prokurorit dhe kanë bë pyetje direkte e indirekte, me zbulue mos u bo ndonjë dallavere, po s'kanë mujt me i gjet ato dallavere. Nëse ju keni vërejtje, ju kisha lut – anëtarët e Komisionit janë këtu, shkoni me emër dhe mbiemër: Dyshojmë te filan personi i cili është fut në listë dhe nuk ka dëm. Nëse është ai i Bresanës,

qe është Vetim Hasani këtu, e gjë dosjen, del këtu para kamerave, i tregon dokumentacionin edhe jua jep juve. Në këtë formë, ju mundeni me i kontribue këtij procesi. Nëse ju shkoni në mënyrë të përgjithësime, thoni janë fry listat, janë minimizuar listat, dikush ka hy që nuk është, ose dikujt i është dhënë më shumë, kjo është vetëm me bo politikë edhe është fushatë. Unë ju kisha lut, nëse keni vërejtje që dikujt i është fry, tregoni me emër e mbiemër, del anëtari i Komisionit e tregon, e arsyeton. Dëgjo, ti dole në mënyrë të përgjithësime fole deri tash. U tha sa me opozitën nuk ka pas bashkëpunim, edhe me Kuvendin. Nga vetë fakti që kryesuesja e Kuvendit ka marrë pjesë kur është formue Komisioni, kjo tregon që ka pas bashkëpunim. Kryesuesja e Kuvendit, si përfaqësuese e juaja ka qenë edhe në terren, i ka parë dëmet, i ka dhënë sugjerime edhe Komisionit. Ka edhe prej jush që kanë dalë, po doktor unë e di që ti nuk ke dalë asnjëherë, s'të kam parë kërkund. Kështu që mos akuzo pse s'po bashkëpunon kryetari me opozitën ose me Kuvendin. Unë sa herë ka pas nevojë e kam thirrë kryesuesen, e ajo ka marrë pjesë. Mërgata pse nuk ka dokumentacion. Këtu janë anëtarët e Komisionit, mujn këta me dalë me e thënë mendimine vet. Kemi pas problem me mërgatën, se disa nuk kanë ardhë. Këta kanë qenë në vend të ngjarjes, ose shpia ka qenë e mbyllur, ose nuk kanë pas mundësi me sigurue dokumentacionin. Po ndërkohë, shumicën dërmuese të tyre i kanë sigurue edhe ata janë në listë. Po ka një pjesë që nuk janë në listë, për arsye se nuk kanë pru dokumentacion. Nuk mundemi ne me fut diçka që nuk mundemi me e dokumentue me fotografi edhe me fakte. Disa fermerë të fshatit Pllajnik pse nuk janë në listë. Unë nuk e di, këtë do të dalë kryetari i Komisionit. Unë e di që ata janë në listë, por janë kërkuar dokumentacion shtesë. Ose i kanë pru fotografitë pa ngjyra, sepse Komisioni qendror na ka thënë që duhet patjetër me i pru fotografitë me ngjyra. Ka edhe disa tjerë, të cilët në vend të konfirmimin bankar e kanë pru fotografi kartelën e bankës, e kjo në bën. Ka dikush nuk e ka pru kopjen e letërnjoftimit. Ato janë çështje teknike që plotësohen. Nga Komisioni qendror nuk na kanë thënë që lista duhet të publikohet, as nuk na kanë thënë që të jepet afat për ankesa. Rruga ligjore është Komision-Asamble-nivel qendror. Këtë rrugë duhet me e njdek. Pasi të miratohet lista, ju a e bëni publike këtë listë a jo, është çështja e juaja. A gaboni, a s'gaboni, unë nuk e di. Por nëse gaboni, është përgjegjësia juaj, nëse nuk gaboni është mirë, unë jam për me pas transparencë, le ta shohin njerëzit, cili sa ka marrë ose sa i është vlerësue. Vulën e krejt kësa, në fund e qet Komisioni Qendror për Vlerësimin e Dëmeve. Ne edhe pse e çojmë këtë listë, Komisioni Qendror ka me u ulë detajisht, person për person ka me e analize. Kryetari i Komisionit, z.Lajqi, na ka thënë edhe pse ju e bini listën, ne do të ulemi, emër për emër, dosje për dosje, do ta analizojë. Ka mundësi që jua kthejmë në rishqyrtim, ka mundësi që lypin dokumentacion shtesë, ka mundësi që diku nëse ka fryrje e zvogëlojnë, nëse diku ka minimizim e rritin. Vetë, tek dëmet në bujqësi, nga niveli qendror janë të caktuara saktë çmimet. Komisioni qendror është kompetent i cili ee bën këtë, se ai i lëshon parat. Unë po të tregoj qysh shkruan në ligj edhe qysh e kanë bo deri tash, se nuk jemi na të parët që bëjmë vlerësim të dëmeve. Kanë bo shumë komuna. Unë mendoj

që shumicën e pyetjeve iu përgjigja. Por, e kisha lut ndonjërin prej anëtarëve të Komisionit, ju mund të ju jepni sqarime delegatëve që kanë bërë pyetje. Nëse jo, atëherë kryetari i Komisionit le të dalë të japë sqarime. Unë jap i mendimit që kjo duhet të përfundojë sot. Qata persona të cilët nuk janë në listë, nëse nuk janë, kryetari i Komisionit ka me i lexue emrat, me i vlerësue edhe shumë sa iu bë, edhe këto do të bëhen pjesë e kësaj listës që e keni marrë. Faleminderit!

Jetmir Ajdini: Atëherë, kryetar, pasi deshte konkretisht me shkue me emra, në familjen Murati, muri mbrojtës që është rrezue prej lumit – familja e ka ndreq atë mur vetë, i ka kushtue me vlerë mbi 6 mijë euro. Me punë, me mjeshtër e me krejt, i ka kushtue mbi 6 mijë euro. Në vlerësim të Komisionit është 2200 euro vlere e kompenzimit. Konkretisht, Eqerem Murati...është në listë, vlerësimi është bo 2200 euro. Unë për atë të thashë, nuk kemi nevojë me u ngut. Të bëjmë vlerësim real të dëmeve, t'i kompenzojmë realisht qytetarët, përnime sa është bo dëm, e jo të votojmë diçka që nuk është reale, të shkilen qytetarët edhe të mos kompenzohen për ato dëme që janë bo. Ne jemi pro për me votue, pro për me i kompenzue qytetarët, por vlerë reale i dëmit sa është bo. Le të dalë dikush prej Komisionit, le të ma arsyetojë pse është kjo, një prej rasteve, e po besoj që ka edhe shumë të tjera. Le të tregojë Komisioni çka është vlerësue edhe qysh është vlerësue, kur atij i ka kushtue mbi 6 mijë euro vlere, me punë e material e me të gjitha, a prej Komisionit është vlerësue 2200 euro. Është një shumë gati 4 mjë euro, që është disproporcion i madh. Në pjesën ku po foli konkretisht, aty kalon lumi i fshatit, i bjer asaj pjese dhe e ka rrezue qat mur. Ai mur që ka ra, e ka rrezikue edhe rrugën të cilën e ka shtrur Komuna. Për mos me shkue edhe rruga dëm, ata me vetiniciativë, me mjete vetanake, e kanë financue, e kanë ndreq atë mur. Besoj që e ka njoftue ai Komisionin, për arsye të urgjencës që ka pas, se ka mund me rrëshqit edhe rruga, edhe ata me mbet pa qasje në shpia të veta. Le të japë përgjigje Komisioni, një prej rasteve që po e cekim, e po besoj që ka shumë ankesa. Për atë e lypa një afat ligjor të ankesave, të kompenzohen me dokumentacion e me të gjitha çka ka nevojë, të kompletohet edhe të votojmë një listë unike. Jo, s'e kam personalisht kurgjo, absolut kurgjo. Katunar, Eqerem Murati, e njohish edhe ti, edhe unë. Kurgjo personalisht s'e kam, përveç katundar.

Arijeta Skeraj: Më vjen mirë që z.Jetmir e cekim që ka kështu parregullsi. Deshta të ju lajmëroj të gjithë Kuvendin, që z.Lajqi ka thënë që edhe katër herë, nëse ka parregullsi, ka me u kthye prapë. Kështu që, pas kryetarit të Komisionit, z.Florim, që ka me e dhënë një sqarim, do ta hedhim në votim, dhe në qoftë se ka disa parregullsi, atëherë do të në kthehet prapë. Kështu që, Komisioni duhet me qenë shumë i kujdesshëm për këtë punë që e ka marrë.

Flroim Krasniqi: Vetëm një sqarim. Deshta me thënë që këto që janë në pritje, e kemi rastin e Pllajnikut, punë është që ata e kanë bërë kërkesën, mirëpo nuk është ofruar dokumentacione përkatëse. Këto mund të kanë kërkuar por nuk kanë hy në kriteret e vlerësimit, nuk është ofruar dokumentacion, ose ka shkue Komisioni e nuk ka pas çka me vlerësue, nuk e ka çelë derën hiç.

Arijeta Skeraj: Dëgjoni, Uran, krejt kohën e keni pas të kufizume, ju kisha lut mos me m'qit edhe mu poshtë. Edhe ne e kemi dhimbjen si ju, që jemi pozitivë edhe ne i kemi ato të drejtat. Sa herë e ke marrë Uran fjalën? Ti po më thuesh me Rregullore, po me Rregullore veç një herë për një pikë të rendit të ditës, edhe sa herë të përmendet emri. Ta kam dhënë fjalën ma shumë se që duhet. Kështu që, ju kisha lut, fjalë nuk jap! Do ta qesim në votim! Pika e rendit të ditës qitet në votim! Kush është pro Propozim-vendimit për miratimin e Raportit të Komisionit Komunal për Vlerësimin e Dëmeve të Shkaktuara nga Fatkeqësitë Natyrore?

Uran Halimi: Të nderuar delegatë, të nderuar qytetarë, në shenjë proteste, neve si Grup Parlamentar na duhet me e lëshue këtë seancë, për shkak të parregullsive.

Shpetim Hajredini: Unë e kërkova edhe më herët – po më vjen shumë keq, të kërkoj falje që më detyrove në këtë pozitë me të qit, nuk jam person që dëshiroj të qes në këtë pozitë. Por, për faktin që nuk e morëm përgjigjen e duhur, unë kërkova edhe në fjalimin e mëhershëm, që ta kemi listën përfundimtare. Ju lutëm! Ne nuk e kemi listën përfundimtare, ne jemi duke e votuar listën pa ankesat e qetyre qytetarëve që i ke jashtë. Pa marrë parasysh sa janë, tre apo edhe një nëse është, përmirësone listën, na sjellni këtu, mas dhjetë minutave, unë kesh shumë i qartë, i hapët për me e diskutue këtë. Nuk jemi si Grup kundër që ta votojmë këtë propozim të juajin. Absolutisht nuk jemi kundër! Bine të kompletuar, të plotësuar në tërësi, përgjegjësia bie mbi Komisionin dhe ekzekutivin, ne e votojmë.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Atëherë, nuk do të dalim në pauzë, do ta qesim në votim në votim. Pikën e rendit të ditës. Kjo është lista finale, ata që nuk janë, në Komision keni me i çue emrat. Në qoftë se janë gabim Komisioni, ka me u kthye prapë kjo. Atëherë e hedhim në votim. Kush është pro kësaj pike? A ka kundër? A ka abstenim? Me 18 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë këtë pikë. Po vazhdojmë me pjesë e dytë të seancës. Është pika e dytë: Rishqyrtimi i Vendimit për miratimin e Statutit të QKMF-së. Para se me e nis diskutimin për këtë pikë, kryetari i Komisionit për Vlerësimin e Dëmeve i ka mbet borxh një sqarim të vogël me e marrë. A po duash, Jetmir, sqarim, a jo? Për atë çështjen që e ke ngrit? Jo. Atëherë, fillojmë me pikën e dytë. E hapim diskutimin!

Artan Loshaj: Ne patëm dëshirë në fillim me dalë drejtori i Shëndetësisë, me na dhënë sqarime se pse janë bo këto ndryshime, edhe pse herën e parë kur kemi bo kritika na, nuk na janë pranue si opozitë. Po më vjen keq shumë për kryetarin, se në fillim ia kam thënë, tash po vjen kryetari në ato fjalët e mia po nuk e pranon. Kur i kam thënë që një mësues, një doktori 30-vjeçar, me renome, me iu bo këshilltar, të kam thënë kryetar mos kofsha në lëkurën tënde. Një mësues klasor me e këshillue, këshilltar me iu bo një kryetari të Komunës që është mjek specialist, unë në fillim i kam thënë – qe ku e keni, hajde le të dalë të thotë pse ka ndodhë kjo – nuk di ai, se është i zënë me urbanizmin. Në fillim ju kam thënë, ai nuk është drejtor i Shëndetësisë, është drejtor i kubëzimeve, i kockave, i kanalizimeve, se qaty është përfitimi, i ka marak tenderat. Ky për shëndetësi që i folish, ky është laik i shëndetësisë, ju kam thënë

në fillim. Në fillim ju kam thënë ndërrone, ndërronja pozicionin. Bean Hadziasanin qitne në shëndetësi, se është jurist, këto sendet i bën. Ama, mësuesin me e bo këshilltar, erdhët në fjalët e mia, le të dalë ty fjalë le t'i fol pak, masnej do të dalë unë. Po s'ka çka me folë, se s'di me folë.

Sefidin Mejzini: Artan, unë e kam për me të mbrojt ty, se disa seanca, është ofendim për mësuesit, duhesh me iu kërkue falje. Nuk e di unë kë e ke pas mësues ti, duhet me pas respekt vetëm për mësuesin tënd, jo për ne tjerët, se edhe unë jam mësues, s'e di çka kam mangu prej tesh najsend, e prej këtyre, pse jam mësues. Ta kam thënë edhe privatisht, duhet me iu kërkue falje mësuesve, se po i ofendosh disa herë. Vetëm një sqarim për këta kolegët. Ndoshta prej krejtve kam muhabet privatisht ma shumë me Artanin. Po dola me qëllim që me ia bo me dije, disa herëm ndoshta pa qëllim e bën – nuk e lejoj kërkond me m'ofendue këtu, e unë e kam dinjitetin tem, e kam profesionin tem. Kryetarin e Komunës e ke doktor, a e ka të ndalume ai me qenë kryetar i Komunës? Po edhe një mësues ka të drejtë me qenë këshilltar, se të ka mësue me folë, të ka mësue me shkruie, edhe ti tash çohesh – me gjithë respektin që e kam, po nuk po më pëlqen mënyra se si po i qasesh këtij muhabetit. Mos të lutem, se mësuesit goxha e kanë një punë të rëndësishme, të kanë mësue me diskutue, me shkruie, edhe tash ti gjithmonë me ofendue. Merre me diçka tjetër, po mos thuj mësues, se e ka krye nje fakultet, i edukon brezat, i edukon fëmijët. Tash nuk është në rregull, të lutem!

Artan Loshaj: Zotni Sefidin, sefte ty të kërkoj falje, në qoftë se je ndie i ofenduar, edhe krejt mësuesve. Unë nuk kam send me mësuesit, ata na kanë pru këtë gjeneratë. Po unë e pata – nashta nuk po mundesh me e deshifruie ti – një mësues, nuk thashë që nuk bën, veç të jetë këshillëtar i doktorit në shëndetësi, kjo është katastrofale. Kërkund nuk ka ndodh në Republikë të Kosovës. E përmendet edhe te ju, ka qenë edhe te na, po Shabani ka qenë biolog. Ama mësuesi të jetë këshilltar i mjekut specialist! Këtu e pata unë, nuk i ofendoj mësuesit unë. Respekt të madh kam për mësuesit, po i keqinterpretosh fjalët e mia, se pa e krye fjalimin, kështu që të kërkoj falje nëse je ofendue ti, edhe krejt mësuesave. Prapë po ta përsëriti, nuk ka ndodh edhe nuk ka me ndodhë një mjekut specialist 40 vjet, me renome, emër i njohur, Dr.Bexhet Xheladini, si mjek, jo si kryetar, ta këshilloje një mësues doktorin, ku ka ma keq. Në qoftë se ndiesh i ofenduar, edhe në qoftë se e keni këshillëtar të mirë, ne ta merr bre dy fjalë le t'i folë, pse qeky neni, pse janë bo qeto ndryshime. Në fillim ju kam thënë e keni gabim, se prapë kanë me e kthye. Erdhët te fjalët e mia. Hajde, qe unë s'po di, prapë po kërkoj falje. Le të vjen e le t'i folë dy fjalë. Pse janë bo këto ndryshime? Hajde, prapë të kërkoj falje, edhe një herë po të kërkoj falje. Nuk di ai. Jo që nuk di, është shumë i nxënë, se ma shumë rri në urbanizëm, se që rri në shëndetësi. Në urbanizëm ku bëhen kanalizimet, kubëzimet, ndërtimet, krejta i di. Se është marakli i tenderëve.

Bexhet Xheladini: Unë jam shumë i lumtur edhe jam shumë krenar që e kam një këshillëtar politik, dejtore të Shëndetësisë, edhe unë jam shumë i kënaqur me punën e tij. Siç e dini, edhe në mandatet tjera ka qenë ky, edhe krytarët tjerë e kanë pas si këshillëtar politik. Me ligj, edhe bariu ka të drejtë me qenë

këshillëtar politik, ka të drejtë edhe me kandidue për kryetar, me i fitue votat edhe me u bo kryetar. Drejtori i Shëndetësisë, z.Behar Brenoli, është treguar një menaxher i mirë, ne shëndetësinë sot e kemi jashtëzakonisht në këmbë shumë të shëndosha. Jo vetëm falë tij, po falë të drejtorit të QKMF-së, falë të stafit që e kemi të shkëlqyeshëm aty, edhe normal, falë Komunës e cila angazhohet që t'i ndohmojë shëndetësisë. Kështu që, unë nuk jam pishman aspak që atë e kam emëruë këshilltar politik për shëndetësi. Edhe mandatin tjetër, nëse do të jam kryetar, prapë do të jam drejtor i Shëndetësisë. Ky është treguar një menaxher i mirë, nuk ka nevojë me qenë doktor i shëndetësisë. Sadik Idrizi, nëse e dini, ka qenë ministër i Shëndetësisë dhe ai ka qenë mësues. Kështu që, çdo drejtor, çdo post politik, me ligj nuk shkruan çfarë profesioni duhet me pas. Unë dashta të dal edhe një herë tjetër, nëse ka problem me votimin e Statutit, po ne me ligj jemi të obliguar që çdo vendim që e biem na edhe na kthehet për rishqyrtim, ne duhet me ligj ta rishqyrtojmë. Edhe nuk është gabim që e rishqyrtojmë, sepse na nuk mund t'i dimë të gjitha gjërat. Edhe mirë është që ekzitojnë ministrinë, MAPL-ja, që e bëjnë – në këtë rast Ministria e Shëndetësisë e ka bo kontrollin e Statutit që e kemi miratuar na – i ka propozue disa ndryshime, ato ndryshime ne duhet t'i miratojmë edhe QKMF-ja tash duhet të jetë me Statut të ri. Faleminderit!

Uran Halimi: Të nderuar të pranishë, u ndërlidhem te pika e rendit të ditës për rregullimin e atij Vendimi edhe dolëm goxha ma larg. Më pëlqeu mësuesi Sef që e ngriti zërin dhe e mbrojti mësuesin. Mësuesi Sef, u dashtë me e ngrit zërin pak ma herët, kur fola unë te Jeta në Kosovë për një mësuese, nëse të kujtohet. Kam kërkue mbështetje qetu në Kuvend, Mësuesi Sef. Pse nuk e ngrite zërin atëherë, apo ajo është mësuese që nuk është qaq mësuese e mirë. Edhe nuk të ka dhimë qaq shumë, se nuk e ke pas në lëkurë. Apo? Mirë është me e mbrojt, me qenë i paanshëm, deri tash nuk ta kam ndie zërin për një periudhë goxha të gjatë. Tash po më pëlqen, po ngjallish debate, se unë nuk pata me e marrë fjalën hiç. Kam qef unë me e marrë fjalën ju ndonjëherë, ama mësuesi është i shenjtë. E sidomos një mësues punëtor, e dish shumë mirë për çka është fjala. Mbroji mësuesit, edhe unë vetë jam mësues, as nuk jem ndier i ofenduar, se unë s'un bëhem mjek, as këshilltar i mjekut. Nëse unë jam mësues i qasaj lëmie, e përfaqësoj qat lëmi ose flas për qat lëmi për të cilin jam i edukuar. Te pjesa tjetër, te shëndetësia që tha kryetari, është e vërtetë që ti mundesh me pas këdo këshilltar se është emërim politik, nuk është zgjedhje politike. Te gjendja e shëndetësisë, kryetar, i kishe ndreq ato guacat, mirë ke bo. Mirëpo shëndetësi s'ka këtu, munden me pas objekt, investim në infrastrukturë shëndetësore, ama sa i përket shëndetësisë, kryetar, ti e dish qysh është situata këtu. Atje në Opojë mirë që të kemi, se te ti vina kur kemi nevojë, e atë pjesën tjetër, shëndetësinë e Dragashit nuk ta llogarit kush. Edhe me siguri kur smuhet dikush edhe ju jeni vetë ata që thoni shko në Prizren. Deri dje s'ke pas analiza këtu, nja dy vjet bon vaki. Kemi bo kërkesë për qasje në dokumentacion zyrtar, kemi kërkue pse s'po bëhen analiza vjet a parvjet, kur e pate atë aferën e analizave. Asnjë përgjigje! Kemi kërkesë ne si LVV, mundesh me e pa kërkesën, të

protokollume e ke, asnjë përgjigje s'na ke kthye. Gjendja e shëndetësisë, mos të folim. Ky drejtori është shumë i mirë në aspektin e menaxhimit të veturat. Investojmë na në infrastrukturë, qysh thashë edhe ma herët, blejmë vetura edhe dalin shoferat e atyre autoambulancave, edhe thojnë vetura e re nuk po ec mbi 40 km/h. Domehënë, ju shumë shpejt e çoni pacientin në spital, me 40 km/h. Teposhtë shkon ma shumë, se në ler e qesim. Tjetra sa i përket shëndetësisë, te pjesa e mësuesit e tejkaluam atë Rrëgulloren. Po kthehem edhe te Statuti, po qashtu ke nisma, znj.kryesuese. Mundohu me qenë pak a shumë e njëjtë me të gjithë, se e qitën personale në fillim. Jau dhaje fjalën me e vazhdue personalen, nuk i ndërpreve përderisa merreshin me personale, tash mu po duhet me m'kallxue ku jam. Edhe te Statuti i QKMF-së kemi diskutue, e kemi kundërshtue vazhdimisht. Na u kthye ni herë me ndryshime, e kemi vazhdue se iu kongra ntek edhe një pozicion i punës aty, hajde ta ndryshojmë atë. Keni pru në seancë materiale të ndryshme, përveç materialit që e keni thirrë në seancë, na e keni pru pastaj një material këtu, se keni fut edhe diçka që ju ka konvenue në të. S'ka shëndetësi bre këtu, dokumentacion, unë i thashë edhe kryetarit seancën e kaluar, me dokumentacion mirë jeni t'u punue, ama punë nuk është duke u bo. Këtu është esenca. Nëse ne nuk e akuzojmë drejtorin e Shëndetësisë për mospunë, për mungesë të analizave, për mungesë të shërbimeve ndaj qytetarëve, atëherë çka duhet na me bo. Çka duhet me i thënë, me i kallxue që është i bukur ose jo, apo? Jo kryesuese, ne jemi këtu për me e ngrit zërin edhe kërkojmë shërbim në raport me qytetarët. E kanë për obligim me iu shërbye qytetarëve. Statutin kanë me e kthye prapë nëse nuk e perfeksionalizoni, edhe konform ligjeve në fuqi. Faleminderit!

Nedžmidin Sejdlar: Më vjen keq që jam pjesë e këtij kuvendi, që kur një drejtor i suksesshëm, me të cilin presidenti është aq mirënjohës dhe i lumtur, nuk mund të ulet në kompjuter dhe të shkruajë një statut për QKMF në 6 muaj. Më bën të mërzhitem kur të dëgjoj të mburresh për të. 3 herë ministria e kthen këtë statut. Dhe ju thoni nga foltorja se unë kam drejtorin më të mirë. Ju keni një drejtor që nuk mund të krijojë një statut të shëndetit publik në komunë. Kjo është e trishtueshme dhe e trishtueshme. Nëse na mbarojnë shëndetësia dhe arsimiti, çfarë na mbetet? Kjo është detyra e tij. A e keni ndërtuar atë tualet në QKMF. Unë ju tregova fotot, u bënë 7 ditë, tualetet tuaja janë rrëmujë. Vetë vëllai yt të kritikoi. Po flas emocionalisht për statutin e QKMF, i cili është si një kushtetutë e shëndetit publik.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Unë nuk e di kujt i ka ardhë tri herë vendimi prapë. Kjo është e dyta herë, Sejdlar.

Samidin Xheladini: Faleminderit, Nedžmidin Sejdlar, që ma dha mundësinë me ta dhënë edhe ty sqarimin. Po e di që nuk e ke me prapavijë, po derisa flasish qashtu, del në opinion me prapavijë. Sikur që e kanë montue më prapavijë. Gazetarët kanë ardhë në Bresanë. Ka qenë doktori, ka ardhë më është lut mu, bone intervistën ti, unë jam i ri, i dijshe krejt. Unë i kam thënë jo, se këta mashtrojnë, montojnë. Nuk i kam pranue. E kemi thirrë drejtorin e QKMF-së, Ramadan Jasharin, ka thënë jep intervistë se ma keq është mos me dhënë. Na kanë thënë çka po fshehni ju këtu. Me çfarë tendenca kanë ardhë, të

dirigum me ardhë, me tendenca, se na po fshehim pale çka aty. Urdhëro, thashë, dheze kamerën! Ti, unë edhe gazetarja kah të shkojmë bashkërisht. Ku të duash, edhe në tavan ke me hyp. Nëse do me hyp në tavan me kqyr tavanin, ka ardhë në monitorim. Le ta kqyrë, edhe në tavan le të hyp, se qaso njerëz edhe në tavan duhet me i hyp. Edhe çka ka ndodhë, kemi shku bashkë deri atje, i ka pa krejt çka është gjendja faktike. Kur ka ardhë në fund, nuk ka gjet asgjë. I dërguar prej Berat Buzhalës, edhe e kanë çue njerëzit e këtuhit me dirigjim, edhe e ka pranue dhe kur e ka pa që s'ka kurgjo të vërtetë prej asaj... tema është qekjo, e shëndetësisë. Të lutem, unë në temë jam shumë mirë, edhe ti ngoje këtë, se është shumë mirë me e ditë opinionin e gjerë. Tash çka ka ndodhë – për hir të opinionit unë po them këtë, jo për ty – në fund e merr filmin e kohës kur ka qeveris PDK-ja, që e ka bo një tezoll i jemi, me tendenca, ato bërlloget që kanë qenë aty, që ka qenë pandemia – ai ai pastruesi në sabah i pastron ato, ka shkue ai masditë në mbrëmje, janë mbledhë nja 100 infuzione, që s'i ka nxint ato, kur ka ardhë pastruesi në sabah i kë hek ato. Masdite ai e ka krye shërbimin edhe u krye shërbimi. E ka bo filmin edhe e ka publikue – tezoll i jemi është – edhe qat filmin e kanë marrë edhe e kanë shkruë aty shumë mirë “Ky film është i mahershëm”, e ka shkruë ajo se e kam ndjek, në fund të botës kam me të ndjek nëse monton diçka, edhe ajo e ka shkruë aty për mos me mund unë me e ndjek penalisht, e ka shkruë “Ky film është i mëhershëm”. Kjo nuk ka qenë në kohën kur ti po pretendon.

Nedžmidin Sejdilar: E kam fjalën për një video ku ju personalisht hapni dyert, tregoni tualetet, ku pacientët marrin infuzione. Ishte e gjitha katastrofike. Me ardhjen e vëllait juaj në pushtet morët edhe ju përgjegjësi. Kur ndryshon qeveria, merret qeveria, buxheti dhe detyrimet dhe punët e papërfunduara të vitit të kaluar. Gjysmën e drejtorëve e keni trashëguar nga radhët e PDK-së, çka tregon se nuk jeni në gjendje ta organizoni vetë qeverisjen.

Agron Gashi: Gjendja aktuale e QKMF-së në Komunën e Dragashit – janë sytë për të parë, veshët për të dëgjuar – shërbimet janë në nivelin e duhur të kësaj Komuna. Marrë parasysh stafin e punës, me mjekë dhe motra medicinale, shërbimet janë deri tash në mënyrë perfekte. Jam aktual thujse çdo javë më nënën plakë që e kam, dhe aty shërbimi është në nivelin e duhur. Por në anët tjetër, dua të them – lidhur me paraparaket që folën – për z.Brënoli. Skënderbeu luftëtarëve të tij iu drejtua me një fjalë: Lirinë na solli z.Skënderbe. Ai u përgjigj me një fjalë: Lirinë nuk ua solla unë, por e gjeta në mesin tuaj. Dhe nga kjo dua të them, z.Loshaj, e keni sjellur, por tashti po e kryen specializimin.

Artan Loshaj: z.Gashi, në qoftë ke qenë me trup dhe mendje në seancë, unë e pranova që hapat e parë i ka marrë te na. Tash unë e kam kritikue edhe PDK-në kur kam qenë – unë jam asambleist i qytetarëve, jo i partisë – unë e kam kritikue, po atëherë i nderumi kryetari jonë ka qenë biolog, edhe qaq kemi ditë, e kemi marrë. Po qaq kemi ditë, na kanë dënue qytetarët. Veç një doktor specialist me e marrë këshilltar, nuk ka ndodhë dhe nuk do të ndodhë në sipërfaqen e tokës. Shumë në rregull, është person i mirë, është familjar i mirë ndoshta, është mësues i mirë – nuk po e kritikoj unë në jetën e tij private ose profesionale

– unë po e kritikoj në anën e këshilltarit politik të shëndetësisë. Me më këshillue mu si infermier, nuk është shumë problem – po lë ligjin, se ligjin e bën Maliqi – veç një kryetar, një doktor me e pas këshilltar, një mësues, prapë po e them, është e pakapshme. E përmendi Sadik Idrizin, aty ka qenë e kundërta, Sadik Idrizi ka qenë ministër, ka pas këshilltarët e vet jurista e doktora. Ajo diqysh e kap, veç – mësuesi në profesion të vetin është shumë i shenjtë, veç në profesionin e shëndetësisë është laik. Ju lutem!

Jetmir Ajdini: Në lidhje me Statutin, do të dalim te pika e dytë e rekomandimeve, te Neni 6 po thotë: Pasi që QKMF në Dragash ka të punësuar specialistë nga lëmitë tjera, duhet të harmonizohet me paragrafët 7, 9 të formës unike të Statutit. Rekomandimet të cilat kanë ardhë, në pikën 2. Te Neni 6 po thotë: Në rast se QKMF në Dragash ka të punësuar specialistë nga lëmitë tjera, duhet të harmonizohet po thotë më paragrafin 7 edhe 9. Po due me pyet, specialistët të cilët nuk i përkasin QKMF-së në Dragash, a do të vazhdojnë punën aty? Ata i përkasin QKMF-së, se japin shërbime në QKMF. Veç pyetjen deshta me ta bo kështu: qata specialistë të cilët nuk i përkasin me Statut QKMF-së, a do të vazhdojnë punën në QKMF, specialistët të cilët i ke sjellë edhe punojnë sot aty, a do të vazhdojnë punën hala masi të miratohet Statuti, apo do t’u ndërpritet kontrata?

Behar Brenoli: Përshëndetje të gjithëve, sa i përket statutit, nëse e keni ndjekur me kujdes prezantimin tim, atëherë në fillim thashë që Ministria e Shëndetësisë na paralajmëroi rreptësisht që të mos bëjmë asnjë ndryshim në lidhje me formën e unifikuar të Statutit. Kemi bërë ndryshime, ju thashë atëherë se do të na e kthejnë Statutin. Ju akuzoni pushtetin ekzekutiv se nuk punonlicituat dy-tri herë, është hera e parë që Ministria e kthen Statutin me rekomandimet që ka. Ajo që përmendi Jetmiri për paragrafin 6 ishte për specialistët. Meqë nuk kemi asnjë specialist që nuk kemi të drejtë, e hoqëm atë nen, sepse kemi llogaritur që nëse nuk kemi të drejtë të punësojmë specialistë të fushave të tjera, nuk ka nevojë për këtë në Statutin tonë. E hoqëm dhe Ministria e Shëndetësisë kërkoi që të kthehej. Nuk kemi punonjës përveç gjinekologëve, pediatërve, nuk kemi të tjerë. Për shërbimet e kardiologut kemi folur më shumë se një herë, nuk mendoj se duhet të shpjegojmë përsëri. Ju jeni mjek, nuk kam nevojë t’ju shpjegoj juve. Ndryshimet që bëmë në statut u kthyen nga Ministria e Shëndetësisë, kërkuan rreptësisht që statuti të ishte ashtu siç e kërkonin.

Jetmir Ajdini: Drejtor, pyetjen ta bëra shumë të thjeshtë, edhe ty edhe kryetarit. Me Statut janë cilat lëmi i përkasin QKMF-së, cilat lëmi specialistike duhet me dhënë shërbim në QKMF. Përveç asaj, ne kemi edhe specialistë të lëmive të tjera. Qysh jo, atëherë po gënjesh publikisht. Qytetarët e dinë që kemi edhe specialistë të lëmive tjera, te të cilët vijnë e marrin shërbime qytetarët. Unë ta bëra pyetjen shumë të thjeshtë, pa politikë, pa kurgjo. Ta bëra pyetjen shumë të thjeshtë, me këtë Statut që kemi me e miratue na sot, këtyre specialistëve të cilët japin shërbim jashtë Statutit, iu ndalohet veprimtaria në QKMF. Të pyeta, a ka me iu vazhdue kontrata, a ka me iu ndërpre kontrata?

Sefidin Mejzini: E para, Artan, po dika me i lidhë nja dy fjalë mësuesi. Edhe unë sa po e shoh, jeni duke e sulmue atë si mjek. Ai nuk kontrollon pacientë, nuk merr vesh në mjekësi. Ai nuk është mjek specialist, janë mjekët, që është drjetori atje, Ushtruesi i Detyrës. Ata i kontrollojnë pacientët, ai s'kontrollon pacientë. Ju po e sulmoni – unë sa po e kuptoj – sikur me qenë mjek. Te kolega, tha pse. Kallxo.com as nuk e kam përcjellë, as nuk kam me e përcjellë. Edhe ky tha unë jam mësues, si mësues – nëse po gaboj më përmirëso – nuk kisha hy këshilltar. A tha? Si mësues në shëndetësi, qeshtu thaje. Tash kryesues po bën me qenë mësuesi, a po bën? Tash, nuk është në rregull. Po mirë, e kemi votu, na ka thënë çka s'na ka thënë. Ju jeni të pabesë, tradhtara. Ju është dashtë mos me hy në fillim. Unë i kam thënë – me gjithë respektin – nesër, masnesër ke me u ndërrue. Tash, unë as nuk e kam përcjellë as nuk due me e përcjellë, se as që e kam ditë. Kam qenë i njoftuar me email, as nuk kam qenë prezent, as nuk e kam përcjellë asnjë video, hiç, absolut. E kam dëgjue çështjen.

Uran Halimi: Tash u thënë, thuhet që ka me pas njerëz që kanë me pas sy edhe s'shohin, vesh edhe s'dëgjojnë. Pjesën tjetër e dini për çka është fjala. Jau kallxojsh ujkun, turren kah fërkemi. Tjetërkund ke muhabeti, i nderum delegat. Sa i përket kryesues, mish e lakër jeni bo deri më keni vu. Vetë m'ke votue. Po unë s'kam mund votën e juaj me e keqpërdor, se jeni Kuvend, ju kam respektue vazhdimisht. Prapë edhe ju respektoj, se jemi Kuvend. Unë juve nuk ju nguci ndonjëherë, se ju ka pru qytetari këtu, unë e nguci qeverisjen. E dini ju shumë mirë. Mirë që shumë sende i dini, e boni që nuk i dini, ose ia mbani kah fërkemi kështu. Nuk ke çështja te Jeta në Kosovë, jo te fërkemi, te ujku.

Shpetim Hajredini: U debatua mjaft, jo për pikën e rendit të ditës, po për shëndetësinë në përgjithësi. Unë besoj që kjo temë të cilën e diskutuam deri më tani, i kemi edhe nja tre muaj po më doket që na vjen raporti, edhe kemi mundësi sa të doni për shëndetësi. Sot e patëm temën për Statutin, një dokumentacion shumë i rëndësishëm. Por këtu po devijon gjithmonë debati edhe ma shumë po shkon kah politika edhe personalja, sesa ajo që është e rëndësishme për t'u debatuar. Qysh në fillim kur na ka ardhë Statuti, si Grup kemi qenë në mbështetje të këtij dokumentacioni, edhe pse i kem dhënë kritikata edhe propozimet tona që duhet të bëhen. Unë gjithmonë e kam thënë edhe sot po e potencoj prapë, që po më vjen shumë keq që vendimet të cilat po i marrim po na kthehen gjithmonë prapë. Kjo po më vjen shumë keq. Nuk është mirë që edhe prapë na është kthye. Por, shpresoj që tani nuk do të na kthehet dhe këto rekomandime të cilat i ka dhënë Ministria t'i keni marrë parasysh edhe t'i keni plotësuar ashtu si ka kërkue Ministria. Gjithashtu, më erdhi shumë mirë që, pas tri viteve, në shumë seanca unë kam bo kërkesë që vendimet e Ministrisë, kthimet, rekomandimet e tyre të na vijnë edhe neve në material. Deri më sot s'na ka ardhë, sot në seancën e fundit na keni dërgue. Është shumë mirë dhe është për t'ju falënderuar. Se edhe ligjërisht, ju është dashtë edhe ma herët të na dërgoni, por nuk na keni dërgue, tash keni fillue të na dërgoni, është shumë mirë. Ju falem nderit!

Bexhet Xheladini: Sa i përket Statutit të QKMF-së, u përmend që ka vakuum institucional. Derisa të

miratohet i riu, është i vjetri. Këtu nuk ka kurrfarë lëshimi. Më kujtohet shumë mirë që drejtori i Shëndetësisë pat thënë që mos të bëjmë ndërhyrje në Statut, sepse Ministria nuk po lejon me bo ndërhyrje, është kopje në të gjithë Kosovën. Këtu ju delegatët pranuat me i bo ndërhyrjet edhe, qato ndërhyrjet që janë bo, është vërejt që është gabim, edhe tash na kanë ardhë rekomandimet. Është shumë mirë që kanë ardhë, kanë ardhë me nene, se çka duhet të ndërrohet, të zhvendoset apo të hiqet. Tash është mirë që në këtë seancë të kalojë Statuti edhe, pas një muaji, QKMF-ja të fillojë të punojë me Statut të ri. Sa u përket mjekëve specialistë të cilët janë duke punuar në QKMF, ata janë vetëm duke dhënë shërbime në QKMF, ata nuk janë të punësuar nga QKMF-ja, ata janë të punësuar nga Komuna. Punëdhënës është Komuna. Komuna udhëheq me shërbimin parësor shëndetësor, është kompetente. Organizatës e cila ka fituar Thirrjen publike, ne ia kemi ofruar lokalet apo vendin ku do të punojnë këta mjekë. Këta mjekë specialistë – edhe pse dikush ka dëshirë ata mos me punue, edhe ka pas dëshirë edhe ma herët edhe janë ankue në Inspektoriat, dhe është pru Vendimi që ata të largohen, por ne nuk i kemi largue. Nëse ka dikush dëshirë që ata të mos punojnë, unë po ju them që qajo dëshirë s’ka me iu plotësue. Ata kanë me vazhdue me punue, sepse janë në të mirë të qytetarëve edhe janë duke punuar mirë, janë duke ardhë me rregull, nuk kemi vërejtje, edhe ata janë të kënaqur, pacientët janë të kënaqur, edhe ne do të vazhdojmë. Statuti i ri nuk ia limiton atyre mos me punue. Nuk janë të punësuar nga ana e QKMF-së, punëdhënës është Komuna. Ne mundim edhe kështu, edhe në ish-objekin e DKA-së me iu çelë zyrë me ardhë me punue. Po edhe ajo është ndërtesë e Komunës. Ne kemi bo kontratë me QKMF-në, që hapësirat të cilat i përdorin këta mjekë, ia janë dhënë kësaj OJQ-së e cila e ka fituar Thirrjen publike. U fol këtu edhe për mësuesit, e dolën edhe te një mësuese e cila nuk e ka normën tamam. Jeta Xharrës i kam premtue që unë do të merrem me këtë problem, edhe kryesuesja ka premtue që do të merret. Unë kam bisedue me drejtorin e Drejtoratit edhe me drejtorin e shkollës fillore në Blaç. E vërteta është kështu: është thënë që i ka 12 orë, nuk i ka 12 po i ka 16 orë. Kur shkolla nuk ka mundësi me ia sigurue edhe 4 orë tjera në atë shkollë, mësuesja ose mësuesi duhet me e bo një kërkesë, me ia plotësue normën. Unë e inkurajoj mësuesen që ta bëjë atë kërkesë edhe le të çojë në DKA, unë do të angazhohem që kësaj mësueseje t’ia plotësojmë normën, t’ia bëjmë 20 orë. Unë nuk përmenda emër, vetëm u përgjigja, nuk ka nevojë për replikë. Kjo është e vërteta absolute. Kush thotë të vërtetë tjetër, nuk është duke tregue drejt.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Jetmir edhe Uran, anjsërit nuk jua ka përmend emrin. Atëherë, e hedhim në votim këtë pikë. Kush është për? A ka kundër? A ka abstenim? Me 22 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, miratohet Statuti i QKMF-së. E mbyllim këtë seancë! Shihemi në seancën tjetër!